



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Ndhma Juridike Falas për Personat në Nevojë”



TIRANË 2023

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJE	4
2. POBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	6
2.1 Konteksti i problemit social	6
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës	7
3. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	8
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	8
3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	9
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	9
3.4 Peshë në buxhet.....	10
3.5 Feedback-u i subjektit përgjatë auditimit	12
4. DETAJET E AUDITIMIT	12
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	12
4.2 Objektivi i auditimit	14
4.3 Pyetjet e auditimit	15
4.4 Fushëveprimi i auditimit	16
5. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE	17
5.1 A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas?17	
5.1.1 A kanë shfrytëzuar MD dhe DNJF kompetencat e tyre në mirë administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas?.....	17
5.2 A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?	23
5.2.1 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike parësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?	23
5.2.2 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?	30
6. GRUPI I PUNËS	Error! Bookmark not defined.
7. SHTOJCA.....	39

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

BE	Bashkim Evropian
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm Publik
KE	Komisioni Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KC	Kodi Civil
KPC	Kodi i Procedurës Civile
MD	Ministria e Drejtësisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
NJP	Ndhmë Juridike Parësore
NJD	Ndhmë Juridike Dytësore
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
IKV	Indikatorët Kryesorë të Vlerësimit
QSHNJP	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

1. PËRMBLEDHJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 42 dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 6, kanë sanksionuar të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor. Në dispozitat kushtetuese, kjo e drejtë grupohet në katalogun e lirive dhe të drejtave vetjake.

Në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, përfshihet edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesit në gjykatë), e cila konsiderohet si një e drejtë thelbësore që duhet t'i sigurohet çdo individ. Aksesit në Drejtësi është garancia kushtetuese që i mundëson individëve mbrojtjen e të drejtave të shkelura. Kjo e drejtë përbën një element të rëndësishëm të shtetit të së drejtës dhe ka për qëllim të garantojë të drejtën e çdo individit për t'iu drejtuar Gjykatës ose organeve të tjera të administratës shtetërore.

Në vendin tonë, deri në vitin 2008, ndihma juridike parashikohej vetëm në legjislacionin penal, në kuadër të *"mbrojtjes së detyruar"*. Më pas, për herë të parë, në vitin 2008 u hartua një ligj specifik për ndihmën juridike nr. 10039 i vitit 2008. Megjithatë, pavarësisht miratimit të një ligji specifik që sanksionon ndihmën juridike falas, aksesit në drejtësi nuk ishte efektiv, duke diktuar kështu nevojën për ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit.

Në këto kushte, një nga risitë që solli reforma në drejtësi ishte Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", i cili parashikon format, kushtet, procedura dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike falas. Miratimi i Ligjit nr. 111/2017 solli ndryshime thelbësore në skemën e ofrimit të ndihmës juridike falas, të cilat lidhen me:

- Decentralizimin e skemës
- Ofrimin e ndihmës juridike dytësore pas një vendimi gjyqësor;
- Shkriren e Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike (KSHNJ) dhe krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (DNJF);
- Zgjerimin e kategorive shoqërore që përfitojnë nga ndihma juridike;
- Zgjerimin e formave të shërbimit ligjor falas (përfshijmë nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore); et.

Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas janë Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Ndërkohë që, ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike falas janë:

- Juristët (punonjësit me trajnim të posaçëm) pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (QSHNJP);
- Organizatat jofitimprurëse (OJF) të autorizuara;
- Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve;
- Avokatët.

Forma e ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti mund të jepet nëpërmjet shërbimit të:

Ndhmës Juridike Parësore: Përfshin shërbimin dhe këshillimin ligjor, i cili ofrohet për mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen pa qenë e nevojshme t'iu drejtohesh gjykatës. Ky shërbim ofrohet nga tre aktorët e parë të sipërcituar (Juristët e QSHNJP-ve; OJF-të dhe Klinikat e Ligjit).

Këto struktura asistojnë kategoritë përfituese kryesisht në drejtim të informimit; orientimit/këshillimit; hartimit të shkresave zyrtare drejtuar institucioneve të administratës publike; ndihmës në plotësimin e formularëve për përfitimin e këtij shërbimi dhe në plotësimin e dokumenteve që nevojiten.

Ndhmës Juridike Dytësore: Ofrimi i ndihmës juridike dytësore nënkupton ndihmën ligjore të ofruar për përpilimin e akteve apo përfaqësimin ligjor për problematikat zgjidhja e të cilave realizohet nëpërmjet gjykatës. Në ndryshim nga ndihma juridike parësore, shërbimi i ndihmës juridike dytësore jepet në mënyrë ekskluzive vetëm nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Shërbimet e ofruara për këtë lloj ndihme janë: përfaqësimi me avokat falas dhe përjashtimi nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Infografik nr. 1: Ilustrim i organizimit dhe funksionimit të skemës juridike falas



Sa më sipër, projekti auditues me temë “Ndhmja Juridike Falas për Personat në Nevojë” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të garantimit të aksesit të barabartë në gjykatë, duke u fokusuar kështu kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka dhe realizimin e objektivave të saj institucionale. Në këtë mënyrë, u synua të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv i aktorëve të përfshirë në proces, në drejtim të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas dhe monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar kah përfituesve të skemës.

Me qëllim realizimin e këtij objektiv, grupi i auditimit vlerësoi:

1. Efektivitetin e administrimit të sistemit të ndihmës juridike falas;
2. Eficiencën e strukturave përgjegjëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
3. Garantimi i cilësisë së shërbimit të ofruar për kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas.

Pas, analizimit dhe testimit të evidencave, disa problematika që lidhen me mirëadministrimin e skemës së ndihmës juridike falas ishin: mungesa e mekanizmave efektiv të monitorimit; indikatorë kryesorë vlerësimi të pazbatueshëm; numri i ulët i juristëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore në QSHNJP; zyra pritëse jashtë standardeve të miratuara; vlerësimi i performancës së avokatëve pas ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore; etj..

Sa më sipër, në kreun 5 të këtij projekti auditues “Shtjellimi i Pyetjeve Audituese”, janë trajtuar të gjitha problematikat e konstatuara në mënyrë të hollësishme, duke gjeneruar rekomandimet përkatëse për secilën prej tyre, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe efektivitetit të skemës në garantimin e të drejtave të qytetarëve.

2. POBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

2.1 Konteksti i problemit social

“Çdo person që kërkon të mbrojtë të drejtat e tij të shkelura mund ti drejtohet një gjykate të pavarur dhe të paanshme, e cila ka detyrim të zhvillojë një proces të rregullt ligjor dhe brenda një afati të arsyeshëm”¹

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Aksesi në Drejtësi është garancia kushtetuese² që i mundëson individëve mbrojtjen e të drejtave të shkelura. Ky parim është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës, i cili gjen rregullim si në aktet ligjore kombëtare mbi bazën e të cilave funksionon dhe organizohet shteti ashtu edhe në akte ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim.


E drejta e aksesit nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por njëkohësisht edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë të gjithë shtetasve këtë mundësi. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se normat dhe parimet kushtetuese, ku bën pjesë edhe e drejta për akses të barabartë në gjykatë, përbëjnë bazën e nocionit të dhënies së drejtësisë. Njëkohësisht, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar vazhdimisht se kjo e drejtë është thelbësore dhe ka karakter parësor në një shoqëri demokratike për shkak të pasojave që ka në interesat legjitime të individit.

Nga sa më sipër, bazuar në rëndësinë dhe impaktin që ka implementimi i këtij parimi për realizimin e të drejtave individuale të qytetarëve, një nga risitë që solli reforma në drejtësi ishte edhe krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo Drejtori, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacion në fuqi për ndihmën juridike ka për mision garantimin e aksesit të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Ndihma juridike falas e garantuar nga shteti ofrohet në mënyrë taksative vetëm për personat që përmbushin kriteret për të qenë përfitues të kësaj skeme.³ Ky shërbim jepet në formën e ndihmës juridike parësore (konsulenca juridike) dhe dytësore (përfaqësimi në gjykatë), përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore & shpenzimeve gjyqësore dhe përjashtimit nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit.

Për vitin 2022 ndihma juridike parësore numëron 7616 raste të raportuara. Nga totali i rasteve të trajtuara, 65% e përfituesve janë persona në pamjaftueshmëri financiare dhe kryesisht pretendimet e tyre janë të natyrës administrative ose civile.

Grafik nr. 1: Ndihma juridike parësore sipas kategorive përfituese




¹ Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

² Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

³ Personat në pamjaftueshmëri financiare dhe kategoritë e veçanta, të parashikuara specifikisht në nenin 10 dhe 11 të Ligjit nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”;

Grafik nr. 2: Ndhimja juridike parësore sipas natyrës së çështjes

Ndhimja Juridike Parësore sipas natyrës së çështjes



Ndërkohë, ndihma juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të aksesit të barabartë në drejtësi. Gjatë vitit 2022, shërbimin e ndihmës juridike dytësore e kanë ofruar 157 avokatë dhe totali i kërkesave drejtuar gjykatave për këtë lloj ndihme rezulton të jetë 1030.

Sa më lart, duke marrë në konsideratë faktin se ofrimi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore për personat në nevojë apo kategoritë përfituese është faktor i rëndësishëm për të garantuar drejtësinë dhe të drejtat e tyre me karakter personal, ky projekt auditues merr një rëndësi të veçantë.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin Strategjik 2023-2027, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues, duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikën me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar kështu në mirë qeverisje.

Në përfundim, në linjë edhe me rekomandimet e Progres Raportit 2022 dhe Strategjinë institucionale 2023-2027, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit.

3. SUBJEKTET NËN AUDITIM

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim


Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2017, u ndryshua struktura e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke krijuar tashmë një institucion të veçantë, të dedikuar për këtë qëllim. Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të politikave dhe ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas, u vendos të përfshihen si subjekte në këtë auditim **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF)** dhe **Ministrinë e Drejtësisë (MD)**, si institucion epor të saj.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka për mision, garantimin e ndihmës juridike si një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që duhet të ketë çdo individ për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese⁴. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, DNJF duhet të garantojë mjete efektive për të siguruar përmbushjen e qëllimit të ligjit për ndihmën juridike, përmes:

- Sigurimit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e ndihmës juridike;
- Zbatimit të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Ligjshmërisë së procedurave në ofrimin e ndihmës juridike falas, duke mbikëqyrur standardet e ofrimit të ndihmës juridike;
- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike;
- Rritjes së ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve të përfshirë.

DNJF ka një staf prej 25 punonjësish dhe organizohet në 3 drejtori kryesore. Më poshtë është paraqitur struktura organizative e miratuar e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”:

Infografik nr. 2: Struktura e DNJF



Burimi: DNJF

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF administron edhe 14 (katërmëdhjetë) qendra në qytetet Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Shkodër, Lushnje, Pogradec, Gjirokastrë, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat dhe Elbasan. Disa prej tyre financohen me fonde të buxhetit të shtetit, ndërsa pjesa tjetër nga UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim).

⁴ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/rreth-nesh-2/>;

3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Burimet e kriterëve të politikës

- VKM nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit”.

Burimet e kriterëve të monitorimit dhe raportimit

- Raportet e inspektimit të ushtruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në qendrat rajonale;
- Raportimet periodike të DNJF në Ministrinë e Drejtësisë;
- Raportimet periodike të qendrave rajonale në DNJF;
- Raportet e analizave vjetore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për vitet 2020-2022.

Burimet e kriterëve teknike

- Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Ligj nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar;
- Ligj nr.10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
- VKM nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;
- VKM nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- Urdhër nr.59, date 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe te organikes se Drejtorisë se Ndhmës Juridike Falas”;
- Urdhër nr. 225 date 25.3.2019 “Për miratimin e formularëve te ndihmës juridike te garantuar nga shteti”;
- Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020 për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore;
- Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr.17, datë 5.8.2020 Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve, që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative;
- Rregullore e Brendshme e DNJF.

Burimet e kriterëve të tjera/ Praktikë më të mira

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa e Hagës për Akses Ndërkombëtar në Drejtësi;
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial.

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektivitetit

Në funksion të realizimit të objektivave dhe misionit të saj institucional, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ofron ndihmë ligjore për personat në pamundësi financiare dhe kategoritë e veçanta të përcaktuara nga ligji. Forma e parë e ndihmës ligjore apo ndryshe *Ndihma Juridike Parësore*, është ai lloj shërbimi ligjor i cili ofrohet për mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen pa qenë e nevojshme t’i drejtohesh gjykatës⁵. Kjo ndihmë ofrohet nga:

1. Juristët pranë qendrave të shërbimit të ndihmës ligjore;
2. Organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
3. Klinikat e Ligjit pranë Universiteteve;

Ofruesit e NJP orientojnë dhe këshillojnë shtetasit mbi mënyrën se si ata duhet të veprojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre, i informojnë ata në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së


⁵ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/ndihma-juridike-paresore/>;

Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e tyre, etj. Gjithashtu, këto struktura mund të hartojnë shkresa zyrtare drejtuar institucionit me të cilin individit është në konflikt me qëllim zgjidhjen e problematikës, por edhe i ndihmojnë ata në plotësimin e formularëve për përfitimin e shërbimit dhe në plotësimin e dokumenteve që nevojiten.

Forma e dytë e ndihmës ligjore apo ndryshe *Ndihma Juridike Dytësore*, është shërbimi ligjor që ofrohet për problematikat zgjidhja e të cilave mund të realizohet nëpërmjet gjykatës⁶. Kjo lloj ndihme ofrohet nga avokatët e licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjithashtu, personat që përfitojnë nga kjo formë e ndihmës juridike mund të përfitojnë përjashtim nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit) apo nga parapagimi i tarifës së ekzekutimit të vendimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

M e qëllim mbikëqyrjen e standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike nga këto struktura, DNJF kryhen monitorime të vazhdueshme mbi to, përfundimet e të cilave paraqiten në raporte të hartuara sipas një metodologjie të miratuar.

Infografik nr. 3: Skema e ofrimit të Ndihmës Juridike Falas



Burimi: Grupi i auditimit

3.4 Pesha në buxhet

Për realizimin e detyrave funksionale, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka buxhetin e vet institucional, i cili përbën pjesë të veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Për vitin 2022, DNJF ka patur si qëllim të saj ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike falas për individët që plotësojnë kushtet, si dhe zbatimin dhe monitorimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me financim nga buxheti i shtetit janë miratuar dhe funksionojnë 4 qendra të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore në: Tiranë, Lushnje, Durrës dhe Shkodër. Referuar të dhënave buxhetore për vitin 2022, vëmë re një realizim në vlerë prej 36.837.614 lekë të shpenzimeve të fondeve të financuara nga buxheti i shtetit.

⁶ [https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/dytesore/;](https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/dytesore/)

Tabela nr. 1: Fondet e akorduara nga buxheti i shtetit dhe donatorët dhe realizimi i tyre në vlerë dhe përqindje


në mijë lekë

Art.	Emërtimi	Plani viti 2022	Realizimi viti 2022	Realizimi në përqindje i buxhetit
600	Paga	17,400.0	17,124.2	98%
601	Sigurime Shoqërore	2,900.0	2,826.0	97%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	25,084.0	15,406.6	61.40%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	516.0	299.0	58%
231	Kapitale të trupëzuara	1,300.0	1,181.9	91%
	Shpenzime Korrente	47,200.0	36,837.6	78%
	Të ardhura jashtë limiti	18,814.3	14,198.2	75.50%
	Të ardhura jashtë limiti	1,671.8	1,109.4	66.40%
	Shpenzime nga të ardhura jashtë limiti	20,486.2	15,307.6	75%
	Totali (korrente + kapitale + Shpenzime nga të ardhura jashtë limiti)	67,686.2	52,145.2	77%

Burimi: DNJF/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Pjesë e buxhetit të DNJF-së janë edhe fondet e akorduara në formë granti nga donatorët. Për vitin 2022 DNJF ka akorduar fonde nga dy organizata ndërkombëtare UNDP dhe OSFA për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike falas në qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë.⁷ Fondet e akorduara gjatë këtij viti janë në vlerën 20.486.156 lekë, me fokus pagesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore. Ky fond është realizuar në vlerën 15.307.517 lekë ose e thënë ndryshe në masën 75% në vitin 2022 dhe fondet e mbetura janë mbartur për përdorim në vitin 2023 në koherencë të zbatimit të akt-marrëveshjeve dhe kontratave me donatorët.

Grafik nr. 3: Realizimi i fondeve buxhetore të DNJF për vitin 2022



Burimi: DNJF/ Përpunoi: Grupi i auditimit

⁷ Gjithsej 10 qendra me financim nga UNDP dhe 2 punonjës paraligjor nga OSFA;

3.5 Feedback-u i subjektit përgjatë auditimit

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit bashkëpunoi me subjektin nën auditim, me qëllim vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas i është përgjigjur në kohë takimeve konsultuese, intervistave paraprake dhe kërkesave për informacion, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, me qëllim adresimin e problematikave reale të performancës së subjektit dhe përmirësimit të tyre pas rekomandimeve që do të japë KLSH.

Të njëjtën frymë bashkëpunimi grupi i auditimit e konstatoi edhe në fazën e terrenit. Gjatë kësaj faze, grupi i auditimit dërgoi pranë DNJF-së intervistat për konfirmimin e të dhënave zyrtare, në përputhje me nenin 15, pika (dh) dhe (e) si dhe me nenin 26 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Intervista iu dërgua subjektit nën auditim në mënyrë elektronike. Përgjigjet e gjeneruara prej tij u përcollën në kohë dhe u trajtuan nga grupi i auditimit, me qëllim gjenerimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve në përfundim të punës audituese.

4. DETAJET E AUDITIMIT

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjektit të përfshirë në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ai has në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT.

Analiza SWOT paraqet fuqitë dhe dobësitë e institucionit që janë faktorë “brenda kontrollit menaxherial”, si dhe shanset dhe kërcënimet që janë faktorë “jashtë kontrollit menaxherial” ose të klasifikuara si risqe nga faktorë të brendshëm dhe risqe nga faktorë të jashtëm.

Kur risqet vijnë nga faktorë të brendshëm, institucioni duhet të mbështetet në fuqitë dhe të minimizojë dobësitë, ndërsa kur risqet vijnë nga faktorë të jashtëm institucioni duhet të shfrytëzojë shanset dhe të shmangë kërcënimet. Disa nga dobësitë institucionale që cenojnë menaxhimin me efektivitet të shërbimeve të ofruara DNJF, janë:

- Numri i ulët i juristëve në qendrat e ofrimit të ndihmës parësore;
- Kushtet infrastrukturore të qendrave të ofrimit të ndihmës parësore;
- Numri i ulët i stafit monitorues për garantimin e shërbimeve cilësore gjatë ofrimit të ndihmës juridike falas;
- Vlerësimi pas fakti i cilësisë dhe standardeve të shërbimit për ofruesit e ndihmës juridike dytësore.

Të gjitha dobësitë e evidentuara ndikojnë drejtë për së drejti në shërbimin që i ofrohet qytetarit dhe garantimin e të drejtave të tij.

Ndërkohë që, përveç dobësive, grupi i auditimit ka evidentuar edhe disa faktorë jashtë kontrollit menaxherial që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave institucionale të DNJF-së në menaxhimin e skemës së ndihmës juridike falas. Këta faktorë janë:

- Fakti i të qenit një institucion i krijuar rishtazi;
- Mbledhja e raportimeve nga OJF dhe Klinikat Ligjore;
- Ndryshimi i hartës gjyqësore; etj.

Infografik nr. 4: Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimi

Pasi u paraqitën risqet e mjedisit të jashtëm dhe risqet e mjedisit të brendshëm që cenojnë ofrimin e shërbimeve kah individëve, më poshtë është paraqitur klasifikimi i tyre në risk strategjik, financiar, juridik, taktik dhe operacional.

Tabela nr. 2: Klasifikimi i risqeve strategjike, financiare, ligjore, taktike, operacionale

	Ulët	Mesatare	Lartë
Strategjike			- Mungesa e një minimumi jetik të përcaktuar.
Teknike		- Vlerësimi pas fakti i cilësisë dhe standardeve të shërbimit. - Ndryshimi i hartës gjyqësore.	- Fakti i të qenit një institucion i krijuar rishtazi.
Operative		- Kushtet infrastrukturore të qendrave të ofrimit të ndihmës parësore; - Mbledhja e raportimeve nga OJF dhe Klinikat ligjore.	- Numri i ulët i juristëve në qendrat e ofrimit të ndihmës parësore; - Numri i ulët i stafit monitorues;

Burimi: Grupi i auditimi


4.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Ndhimja Juridike Falas për Personat në Nevojë” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të garantimit të aksesit të barabartë në gjykatë, duke u fokusuar kështu kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjekti nën auditim ka dhe realizimin e objektivave të tij institucionale. Në këtë mënyrë, u synua të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi i institucioneve të përfshira, në drejtim të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas dhe monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar.

Sa kaq, grupi i auditimit vlerësoj:

1. Efektivitetin e administrimit të sistemit të ndihmës juridike falas;
2. Eficiencën e strukturave përgjegjëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
3. Garantimi i cilësisë së shërbimit të ofruar për kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas.

4.3 Pyetjet e auditimit



Burimi: Grupi i auditimit

Pyetja kryesore: A garanton sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas akses të barabartë të individëve në sistemin e drejtësisë?

Pyetjet e nivelit të parë:

A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

Pyetjet e nivelit të dytë:

A kanë shfrytëzuar MD dhe DNJF kompetencat e tyre në mirë administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike parësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

4.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim u fokusua në realizimin e objektivave të sistemit të ndihmës juridike falas, për sa i përket shërbimit të ofruar për kategoritë përfituese, si dhe cilësisë së tij. Periudha e auditimit ishin vitet 2020-30.06.2023.

Nxitja për ndërmarrjen e këtij auditimi performance erdhi si pasojë e faktit se DNJF është një institucion i krijuar rishtazi dhe për rrjedhojë, nuk ka qenë me parë subjekt i audituar nga KLSH.

Aksesi i pakushtëzuar në gjykatë përbën një nga elementët kryesor të procesit të rregullt ligjor. Ky parim rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garanton barazinë e palëve në një proces gjyqësor. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një e drejtë themelore e njeriut, e cila parashikohet edhe në neni 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo dispozitë nuk sanksionon vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses.

Nga sa më sipër, rrjedhimisht, paradigma e këtij auditimi merr formën: *“Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike falas dhe garantimi i shërbimit efektiv për kategoritë përfituese, përbën një kusht thelbësor për garantimin e një procesi të rregullt ligjor për individët”*.

5. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja kryesore: A garanton sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas akses të barabartë të individëve në sistemin e drejtësisë?

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi arriti në këtë mesazh auditimi:

Garantimi i aksesit të barabartë në drejtësi për personat në nevojë sigurohet nëpërmjet ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe ofrimit të një shërbimi cilësor të asistencës ligjore. Për realizimin e këtij qëllimi, kërkohet një angazhim më i madh i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kryerjen e monitorimeve efektive ndaj ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, i cili do të mundësonte nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garantimin e kushteve infrastrukturore në përputhje me standardet e miratuara.

5.1 A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

5.1.1 A kanë shfrytëzuar MD dhe DNJF kompetencat e tyre në mirë administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

Akcesi në Drejtësi është garancia kushtetuese që i mundëson individëve mbrojtjen e të drejtave të shkelura. Kjo e drejtë përbën një element të rëndësishëm të shtetit të së drejtës dhe ka për qëllim të garantojë të drejtën e çdo individi për t'iu drejtuar Gjykatës ose organeve të tjera të administratës shtetërore.

Deri në vitin 2008, ndihma juridike parashikohej në legjislacionin penal, në kuadër të mbrojtjes së detyruar. Për herë të parë, në vitin 2008 u hartua një ligj specifik për ndihmën juridike nr. 10039/2018. Pavarësisht miratimit të këtij akti, aksesit në drejtësi nuk ishte efektiv, duke diktuar kështu nevojën për ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit.

Në këto kushte, krijimi i mekanizmit të ndihmës juridike falas për personat në nevojë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara për të qenë përfitues të skemës është një nga risitë që sollin reforma në drejtësi. Format, kushtet, procedura dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti përcaktohen në Ligjin nr. 111/2017.

Dhënia e kësaj ndihme ofrohet në dy forma (ndihmë juridike parësore⁸ dhe dytësore⁹) dhe bazohet në parimet e mëposhtme¹⁰:

- aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;
- barazisë dhe mos diskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- cilësisë, efikasitetit dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- ruajtjes së konfidencialitetit;
- shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

Miratimi i Ligjit nr. 111/2017 sollin ndryshime thelbësore në skemën e ofrimit të ndihmës juridike falas, të cilat lidhen me decentralizimin e skemës së ndihmës juridike dhe ofrimin e ndihmës juridike dytësore pas një vendimi gjyqësor.

Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas janë Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

⁸ Ndihma juridike parësore ka si objekt të saj këshillimin dhe orientimin fillestar ligjor në organet administrative;

⁹ Ndihma juridike dytësore ka si objekt të saj përfaqësimin në gjykatë të përfituesve të skemës;

¹⁰ Neni 4 i Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;


Ministria e Drejtësisë zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe mbikëqyr mirëfunksionimin e sistemit, si dhe zbatimin e buxhetit vjetor të fushës. MD raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike.

Ndërkohë që, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i krijuar në vitin 2017, i cili ka si mision kryesor të tij garantimin e aksesit të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.¹¹

Më konkretisht, kompetencat kryesore¹² të DNJF-së në kuadër të mirë administrimit të skemës së ndihmës juridike falas, janë:

- sigurimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e ndihmës juridike;
- zbatimi i politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- ligjshmëria e procedurave në ofrimin e ndihmës juridike falas, duke mbikëqyrur standardet e ofrimit të ndihmës juridike;
- bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike;
- rritja e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve të përfshirë.

Infografik nr. 5: Aktorët e përfshirë në dhënien e ndihmës juridike falas



Burimi: Grupi i auditimit

Personat në pamjaftueshmëri financiare përcaktohen nga ligji si subjekte, të cilët përfitojnë ndihmë juridike falas. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile¹³. Llogaritjet për përcaktimin e pamjaftueshmërisë janë parashikuar specifikisht në metodologjinë e miratuar në nenin 12 të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Lidhur me këtë çështje, konkretisht ligji parashikon se:

¹¹ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/rreth-nesh-2/>;

¹² Rregullore e Brendshme për Funksionimin dhe Organizimin e DNJF;

¹³ Neni 12, pika 1 e Ligjit nr. 111/2017;

- a. të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore;
- b. të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore;
- c. pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore.

Nga sa më sipër, konstatojmë se ligji merr në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e detyrueshme dhe të nevojshme për jetesë. Për përcaktimin e pamjaftueshmërisë financiare, Ministria e Drejtësisë i është referuar modelit Slloven dhe përcaktimeve ligjore që ky vend parashikon. Megjithatë, transpozimi i këtij modeli është i cunguar, pasi Sllovenia, në ndryshim nga vendi jonë ka një minimumin jetik të përcaktuar, i cili reflektohet edhe në përcaktimin e pagës minimale. Në kushtet kur Shqipëria nuk ka të miratuar një akt për përcaktimin e minimumit jetik, përllogaritja e kufirit të pamjaftueshmërisë financiare duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi, por jo shpenzimet e nevojshme dhe të detyrueshme për jetesë është e cenuar dhe rrezikon të përjashtojë nga skema individë, të cilët kanë realisht nevojë për ndihmë juridike falas.

Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike bëhet sipas kriterëve dhe metodologjisë të miratuar nga Ministri i Drejtësisë¹⁴. Ky akt është hartuar në zbatim të nenit 7 të Ligjit 111/2017 dhe përcakton procedurat që ndjek Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për kryerjen e vlerësimit. Vlerësimi i sistemit të ndihmës juridike bëhet sipas indikatorëve (IKV) të përfshirë në dy fusha kryesore:

Struktura organizative / Organizimi	Burimet njerëzore
a. Ambientet e punës	a. Aftësitë profesionale
b. Procesi i punës	b. Etika
	c. Cilësia e shërbimit

Disa nga indikatorët e përcaktuar në metodologjinë e miratuar nga MD, me qëllim vlerësimin e shërbimit si të ndihmës juridike parësore, ashtu edhe të asaj dytësore janë të pa zbatueshëm. Për shembull, vlerësimi i cilësisë së dokumenteve të hartuara, apo analiza e thelluar e çështjes së përfaqësuar nga avokati nuk mund të konsiderohen të zbatueshme. Përcaktimi i kriterëve të pazbatueshme në praktikë në sistemin e vlerësimit të cilësisë së ndihmës juridike, e bën procesin e monitorimit formal dhe nuk inkurajon rritjen e performancës së mëtejshme tek ofruesit e shërbimit. Për më tepër, struktura monitoruese për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike në DNJF përbëhet vetëm nga 2 specialistë, të cilëve iu duhet të monitorojnë dhe garantojnë zbatimin e standardeve të 160 avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore dhe 20 qendrave (QSHNJP) që janë të angazhuara në ofrimin e ndihmës juridike parësore. Duke marrë në konsideratë ngarkesën dhe kohën e nevojshme për vlerësimin e secilës prej këtyre strukturave, konstatojmë se struktura monitoruese nuk mund të konsiderohet efektive.

Përcaktimi i disa kriterëve që nuk mund të zbatohen realisht në praktikë, struktura shumë e reduktuar për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike dhe numri i subjekteve që duhet të monitorohen kanë cenuar vlerësimin efektiv të shërbimit që iu ofrohet individëve përfitues.

Një nga detyrat funksionale të DNJF, përcaktuar edhe në rregulloren e brendshme të institucionit, është e rritja e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve të përfshirë. Në këtë kuadër është shumë i rëndësishëm zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese, të cilat të jenë vizibël dhe të mbulojnë një numër të madh qytetarësh, veçanërisht në zonat e thella rurale. Suksesi i zbatimit të skemës së ndihmës juridike varet nga aftësia e qytetarëve dhe grupeve të marginalizuara për t'u orientuar dhe për t'iu drejtuar strukturave kompetente, ndaj dhe nevojitet një sensibilizim i gjerë

¹⁴ Urdhri nr. 531, datë 25.11.2019 i Ministrisë së Drejtësisë;

i publikut për ndihmën juridike, llojet e saj dhe procedurat për të vënë në lëvizje mekanizmat e parashikuar nga ligji.

Informimi i publikut për ndihmën juridike parësore mund të realizohet nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, por edhe nga vetë aktorët/strukturat që e ofrojnë këtë ndihmë si OJF-të, klinikat ligjore dhe qendrat e shërbimit të ndihmës juridike. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të organizuara nga DNJF në këtë kuadër janë zhvilluar në tryeza të rrumbullakëta ose auditorë, ambiente në të cilat shumica e përfituesve të skemës juridike falas nuk kanë akses.

Gjithashtu, DNJF nuk ka një sistem për të matur impaktin e aktiviteteve të zhvilluara me qëllim sensibilizimin e kategorive përfituese të ndihmës juridike falas. Për shembull, një indikator që mund të mbahet parasysh në vijim është moshja e kërkuesve. Duke qenë se shumica e informacionit aktual për ndihmën juridike falas shpërndahet në tryeza pune, auditorë, në rrjete sociale, ueb faqet e institucioneve, OJF-ve etj., penalizohen grup moshat që nuk kanë akses në këto mjete komunikimi. Për këtë qëllim do të nevojitej një ndryshim i strategjisë së punës së aktorëve të përfshirë në këtë fushë. Kjo do të orientonte OJF-të, klinikat ligjore dhe zyrat e ndihmës juridike parësore në punën e tyre të përditshme, por edhe vetë DNJF për informimin e gjerë të publikut.

E drejta e qytetarëve për t'u ankuar shtrihet mbi të gjitha institucionet e administratës publike në Shqipëri, në linjë me parimet e Kodit të Procedurave Administrative. Veprimtaria kryesore e DNJF është ofrimi i shërbimit të drejtpërdrejtë për qytetarët nëpërmjet qendrave të ndihmës juridike parësore dhe menaxhimi i sistemit të ndihmës juridike me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimit të ofruar. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që çdo individ në lidhje me pretendimet për shërbimin e përfituar në QSHNJP të ketë mundësinë e ankimit.

Nga intervista e zhvilluar me DNJF, u konstatua se përveç koordinatorit për të drejtën e informimit, institucioni nuk ka një strukturë apo person përgjegjës që trajton ankesat e qytetarëve. DNJF argumentoi se kjo vjen si pasojë e faktit që qytetarët në shumicën e rasteve kanë më tepër nevojë për sqarime, se sa të ngrenë pretendime për shërbimin e ofruar. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, duke marrë në konsideratë misionin e DNJF në drejtim të ofrimit të shërbimit cilësor dhe efektiv kah qytetarëve, përcaktimi i një personi përgjegjës për trajtimin e ankesave brenda institucionit është një hallkë e domosdoshme për të siguruar kontrollin e brendshëm administrativ. Për më tepër, pretendimet e ngritura në ankesë mund të përdoren si të dhëna edhe gjatë ushtrimit të monitorimeve që DNJF kryhen në QSHNJP-të.

Zhvillimi dhe menaxhimi eficient i burimeve njerëzore është faktori kryesor në rritjen e efektivitetit të shërbimit të ofrimit të ndihmës juridike. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve, mundëson që aftësimin profesional të tyre, rrit cilësinë dhe produktivitetin e veprimtarisë institucionale. Trajnimi dhe zhvillimi i juristëve që ofrojnë ndihmë juridike duhet të sigurojë një bazë të njohurive, aftësive dhe vlerave profesionale, i cili u mundëson atyre të zhvillohen në vijimësi, të ruajnë kompetencën profesionale dhe të nxisin përmirësimin e etikës dhe komunikimit gjatë ushtrimit të detyrës.

Kjo frymë pasqyrohet edhe në parimet themelore të ushtrimit të veprimtarisë së DNJF dhe QSHNJP-ve, konkretisht profesionalizmi në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike¹⁵. Me qëllim ofrimit të një shërbimi cilësor, punonjësit e DNJF që në momentin e rekrutimit angazhohen në një trajnim fillestar të zhvilluar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me institucionin. Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe vizitat në terren u konstatua se përveç trajnimeve të zhvilluara në bashkëpunim me ASPA-n në vitet 2021 dhe 2022, DNJF nuk ka pasur një rol aktiv në forcimin e kapaciteteve të juristëve të angazhuar për dhënien e ndihmës juridike pranë QSHNJP-ve. Vetë

¹⁵ Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e DNJF-së, neni 6;

institucioni nuk ka një program të planifikimit të trajnimeve vazhduese, në bazë të nevojave që lindin nga rastet praktike të trajtuara nga juristët. Krijimi i mundësive për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme, si dhe kualifikimi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira është i ulët.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që DNJF është një institucion i krijuar rishtazi, nevoja për trajnimin dhe aftësimin e stafit është shumë e lartë. Mbarëvajtja dhe organizimi i këtyre trajnimeve do të përmirësonte aftësitë profesionale dhe menaxhuese të punonjësve, si dhe do të mundësonte njohje dhe zbatim më të saktë të procesit, duke ndihmuar kështu përmirësimin e ofrimit të ndihmës juridike parësore për individët.

Gjetje nga auditimi 1: Për përcaktimin e pamjaftueshmërisë financiare, ligji nr. 111/2017 merr në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e detyrueshme dhe të nevojshme për jetesë.

Gjetje nga auditimi 2: Disa nga indikatorët e përcaktuar në metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë me qëllim vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike, si për shembull vlerësimi i cilësisë së dokumenteve të hartuara apo analiza e thelluar e çështjes së përfaqësuar nga avokati, janë të pa zbatueshëm.

Gjetje nga auditimi 3: Struktura monitoruese për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike në Drejtoria e Ndhmës Juridike përbëhet vetëm nga 2 specialistë, të cilëve iu duhet të monitorojnë dhe garantojnë zbatimin e standardeve të 160 avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore dhe 20 qendrave (QSHNJP) që janë të angazhuara në ofrimin e ndihmës juridike parësore.

Gjetje nga auditimi 4: Drejtoria e Ndhmës Juridike nuk ka një sistem për të matur impaktin e aktiviteteve të zhvilluara me qëllim sensibilizimin e kategorive përfituese të ndihmës juridike falas. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike në këtë kuadër janë zhvilluar në tryeza të rrumbullakëta ose auditorë, ambiente në të cilat shumica e përfituesve të skemës juridike falas nuk kanë akses.

Gjetje nga auditimi 5: Nga intervista e zhvilluar me Drejtoria e Ndhmës Juridike, u konstatua se përveç koordinitorit për të drejtën e informimit, institucioni nuk ka një strukturë apo person përgjegjës që trajton ankesat e qytetarëve.

Gjetje nga auditimi 6: Drejtoria e Ndhmës Juridike nuk ka një program të planifikimit të trajnimeve vazhduese, në bazë të nevojave që lindin nga rastet praktike të trajtuara nga juristët. Krijimi i mundësive për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme, si dhe kualifikimi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira është i ulët.

Konkluzion

- E drejta për të pasur një mbrojtës ligjor, është një nga të drejtat procedurale thelbësore në një gjykim të rregullt ligjor. Në kuadër të parimit të mbrojtjes efektive, sa i përket përcaktimit të pamjaftueshmërisë financiare, Ministria e Drejtësisë i është referuar modelit Slloven dhe përcaktimeve ligjore që ky vend parashikon. Megjithatë, transpozimi i këtij përcaktimi ligjor është i cunguar, pasi Sllovenia, në ndryshim nga vendi jonë ka të përcaktuar minimumin jetik, i cili reflektohet edhe në përcaktimin e pagës minimale. Në kushtet kur, Shqipëria nuk ka të miratuar një ligj për përcaktimin e minimumit jetik, përlllogaritja e kufirit të pamjaftueshmërisë financiare duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e nevojshme dhe të detyrueshme për jetesë është e cunguar dhe rrezikon të përjashtoj nga skema individ, të cilët kanë realisht nevojë për ndihmë juridike falas. Njëkohësisht, edhe mungesa e hartimit të listave të posaçme për përfaqësimin ligjor të të

miturve dhe përcaktimi i përfaqësuesve ligjor të ndryshëm në faza të ndryshme të procesit penal, si për të miturit ashtu edhe tek personat madhor, ndikon negativisht në efektivitetin e procesit të mbrojtjes së tyre.

- Përcaktimi i disa kriterëve që nuk mund të zbatohen realisht në praktikë, struktura shumë e reduktuar për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike dhe numri i subjekteve që duhet të monitorohen kanë cenuar vlerësimin efektiv të shërbimit që iu ofrohet individëve përfitues.
- Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi. Me qëllim që ky mekanizëm të konsiderohet eficient dhe efektiv është i nevojshëm ndërgjegjësimi i qytetarëve lidhur me këtë të drejtë. Kryesisht fushatat sensibilizuese duhet të orientohen tek grupet e marginalizuara, të cilët janë edhe potencial për të qenë përfitues të skemës juridike falas. Këto target grupe kanë nivel mjaft të ulët të njohurive për të drejtat e garantuara nga shteti, prandaj, është e rëndësishme që nëpërmjet fushatave, takimeve dhe aktiviteteve të zhvilluara nga DNJF të arrihet informimi i këtyre qytetarëve lidhur me të drejtat që ata gëzojnë.
- Duke marrë në konsideratë misionin e DNJF në drejtim të ofrimit të shërbimit cilësor dhe efektiv kah qytetarëve, përcaktimi i një personi përgjegjës për trajtimin e ankesave brenda institucionit është një hallkë e domosdoshme për të siguruar kontrollin e brendshëm administrativ. Për më tepër, pretendimet e ngritura në ankesë mund të përdoren si të dhëna edhe gjatë ushtrimit të monitorimeve që DNJF kryhen në QSHNJP-të.
- Duke mbajtur në konsideratë faktin që DNJF është një institucion i krijuar rishtazi, nevoja për trajnimin dhe aftësimin e stafit është shumë e lartë. Mbarëvajtja dhe organizimi i trajnimeve vazhduese do të përmirësonte aftësitë profesionale dhe menaxhuese të punonjësve, si dhe do të mundësonte njohje dhe zbatim më të saktë të procesit, duke ndihmuar kështu përmirësimin e ofrimit të ndihmës juridike parësore për individët.

Rekomandim 1.1: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike të kryejnë një analizë të mirëfilltë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas.

Brenda qershor 2024

Rekomandim 2.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë rishikimin e metodologjisë dhe kriterëve të vlerësimit të cilësisë së dhënies së shërbimeve të ndihmës ligjore.

Menjëherë

Rekomandim 3.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shqyrtojë mundësinë e riorganizimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimeve dhe garantimit të cilësisë së shërbimit.

Në vijimësi

Rekomandim 4.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike, përpara hartimit të kalendarit vjetor të aktiviteteve, të zhvillojë analiza konkrete me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike .

Brenda qershor 2024

Rekomandim 5.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të përcaktojë një strukturë ose person përgjegjës për trajtimin e pretendimeve të ndryshme që vijnë nga qytetarët, lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar sistemi i ndihmës juridike falas.

Brenda dhjetor 2024

Rekomandim 6.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me partnerë, të përgatisë një program të brendshëm trajnimesh vazhduese për të siguruar forcimin e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të punonjësve me trajnim të posaçëm.

Në vijimësi

5.2 A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

5.2.1 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike parësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

Ndihma Juridike Parësore përfshin shërbimin dhe këshillimin ligjor, i cili ofrohet për mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen pa qenë e nevojshme t'i drejtohesh gjykatës. Në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kjo ndihmë ofrohet nga:

- Juristët (punonjësit me trajnim të posaçëm) pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (QSHNJP);
- Organizatat jofitimprurëse (OJF) të autorizuara;
- Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve;

Këto struktura asistojnë kategoritë përfituese kryesisht në drejtim të:

- Informimit të qytetarëve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- Orientimit/këshillimit të shtetasve mbi mënyrën se si ata duhet të veprojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre;
- Hartimit të shkresave zyrtare drejtuar institucionit me të cilin individi është në konflikt me qëllim zgjidhjen e problematikës;
- Ndhmës në plotësimin e formularëve për përfitimin e këtij shërbimi dhe në plotësimin e dokumenteve që nevojiten.


Sipas të dhënave të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (DNJF), numri i rasteve që kanë përfituar ndihmë juridike parësore gjatë vitit 2022 ka qenë 7616, nga të cilat pjesën më të madhe e zënë rastet e raportuara nga QSHNJP dhe OJF-të e autorizuara, përkatësisht 3073 dhe 2788 raste. Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në mënyrë grafike më poshtë.

Tabela nr. 3: Numri i rasteve që kanë përfituar ndihmë juridike parësore gjatë vitit 2022

	QSHNJP-të	OJF-të	Klinikat e Ligjit	Juristi Online	Nr. i gjelbër	Total
Nr. i Rasteve	3073	2788	0	1418	337	7616

Burimi: DNJF

Grafik nr. 4: Numri i rasteve që kanë përfituar ndihmë juridike parësore gjatë vitit 2022



Burimi: DNJF

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron 20 (njëzet) Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Shkodër, Lushnje, Pogradec, Gjirokastrë, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan, Përmet, Pukë, Tropojë, Mat, Kavajë dhe Kurbin. Theksojmë se zyrat përkatëse të QSHNJP në Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë dhe Kurbin kanë filluar të funksionojnë në periudhën korrik-gusht 2023. Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore zakonisht janë të vendosura pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Megjithatë, ka edhe raste kur ato vendosen në ambiente të tjera si p.sh. QSHNJP Tiranë, e cila është vendosur pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë, QSHNJP Fier, e cila është vendosur në ndërtesën e Këshillit të Qarkut, QSHNJP Vlorë, e cila është vendosur në ambientet e Bashkisë, etj.

Disa prej QSHNJP financohen me fonde të buxhetit të shtetit, ndërsa pjesa tjetër nga UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim). Ky financim është i përkohshëm dhe në përfundim synohet që me konsolidimin e sistemit të ndihmës juridike, qendrat e financuara nga UNDP të mbulohen nga buxheti i shtetit. Aktualisht, 12 qendra financohen nga fondet e buxhetit të shtetit, ndërsa 8 prej tyre nga UNDP, sipas marrëveshjes së nënshkruar më korrik 2021. Në tabelën e mëposhtme klasifikohen qendrat sipas burimit të financimit:

	Financuar nga buxheti i shtetit	Ne bashkëpunim me UNDP
1	Tiranë	Lezhë
2	Durrës	Pogradec
3	Lushnje	Dibër
4	Shkodër	Vlorë
5	Tropojë	Elbasan
6	Përmet	Berat
7	Pukë	Kukës
8	Mat	Korçë
9	Kavajë	
10	Kurbin	
11	Gjirokastrë	
12	Fier	

Sipas raportimeve të DNJF, numri i rasteve të trajtuara nga secila qendër për vitin aktual janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4: Numri i rasteve të trajtuara nga secila qendër për vitin aktual

		<i>Janar</i>	<i>Shkurt</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qershor</i>	<i>Korrik</i>	<i>Gusht</i>	<i>Total</i>
		2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023
<i>1</i>	Tiranë	30	30	32	31	30	25	10	18	206
<i>2</i>	Durrës	24	25	22	16	20	19	28	12	166
<i>3</i>	Lushnje	19	19	13	21	24	20	19	14	149
<i>4</i>	Shkodër	30	29	32	32	29	36	35	32	255
<i>5</i>	Tropojë	-	-	-	-	-	-	3	9	12
<i>6</i>	Përmet	-	-	-	-	-	-	0	0	0
<i>7</i>	Pukë	-	-	-	-	-	-	-	2	2
<i>8</i>	Mat	-	-	-	-	-	-	-	0	0
<i>9</i>	Kavajë	-	-	-	-	-	-	-	10	10
<i>10</i>	Kurbin	-	-	-	-	-	-	-	5	5

11	Lezhë	36	28	27	26	29	27	29	29	231
12	Gjirokastrë	37	37	43	34	45	48	40	40	324
13	Pogradec	20	18	27	17	18	10	19	0	129
14	Fier	31	30	34	32	29	37	25	22	240
15	Dibër	6	5	7	6	6	5	4	5	44
16	Vlorë	25	26	30	21	25	19	22	15	183
17	Elbasan	19	18	20	20	23	16	22	17	155
18	Berat	12	7	7	7	6	22	29	20	110
19	Kukës	10	10	10	8	12	9	12	11	82
20	Korçë	6	13	20	12	25	33	15	34	158

Burimi: DNJF

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike në DNJF ushtron kontrole pranë QSHNJP-ve, me qëllim vlerësimin e performancës së veprimtarisë së tyre. Siç është trajtuar edhe më lart, metodologjia e përdorur për kryerjen e këtyre monitorimeve është përcaktuar në Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë. Në bazë të saj, qendrat vlerësohen në drejtim të përshtatshmërisë së ambienteve, procesit të punës dhe kapaciteteve profesionale. Sistemi i pikëzimit për secilin indikator përbëhet nga 5 shkallë, nga “Shumë keq” tek “Shkëlqyeshëm”.

Gjatë kryerjes së auditimit u zhvilluan vizita në terren përkatësisht në QSHNJP-të Tiranë, Fier, Vlorë, Shkodër dhe Lezhë. Problemet kryesore që u konstatuan nga vizitat e zhvilluara lidhen me përshtatshmërinë e zyrave, si dhe numrin e vogël të stafit që ofron shërbim në QSHNJP-të, të cilat funksionojnë me 1 ose në rastin më të mirë 2 juristë. Në disa zyra (p.sh. Lezhë) nuk respektohet privatësia e qytetarit duke qenë se shërbimi ofrohet në ambiente të pa izoluar nga mjedisi përreth, apo zyrat pritëse ndajnë ambientet me punonjës të institucioneve të tjera (Fier). Gjithashtu, zyra e Tiranës nuk është e pajisur me një rampë, për të mundësuar aksesin e qytetarëve me aftësi të kufizuara. Këto mangësi cenojnë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarit në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Figura 1: QSHNJP Fier




Figura 2: QSHNJP Lezhë



Konkretisht, metodologjia e miratuar sugjeron se prania e vetëm 1 juristi për funksionet e pritjes së parë vlerësohet me “Keq”, ndërsa 2 të tillë vlerësohet me “Mirë”. Ky dokument sugjeron se vlerësimin “Shkëlqyeshëm” do ta merrte QSHNJP me të paktën 5 juristë që kryejnë funksionet e pritjes së parë. Problematika bëhet më shqetësuese në zyrat që operojnë me vetëm një jurist, veçanërisht në drejtim të ndarjes/përcaktimit të detyrave, apo në rastet kur punonjësit i duhet të zhvillojë lejen e zakonshme.

Gjithashtu, metodologjia vlerëson me “Keq” rastet kur zyrat e brendshme nuk janë të izoluar nga mjedisi përreth. Edhe për sa i përket aksesit në zyrë, vlerësohet me “Shumë keq” zyra, e cila është plotësisht e pa-aksesueshme nga disa kategori personash me aftësi të kufizuara. Kështu, në raport me metodologjinë e miratuar nga Ministri i Drejtësisë, QSHNJP-të vazhdojnë të jenë jashtë standardeve në drejtim të indikatorëve të sipërpërmendur, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimit të ofruar. Megjithatë, edhe vetë këto kriteret e miratuara janë në disa raste të vështira për tu zbatuar nga monitoruesit dhe lidhin performancën e qendrave me çështje që nuk janë në kompetencën e punonjësve të tyre (p.sh. rastet e përmendura më lart). Po ashtu, edhe kriteret e lidhura me nivelin e arsimit dhe eksperiencën në punë nuk reflektojnë një vlerësim të drejtë, për aq kohë sa punonjësi ka plotësuar kërkesat e vendosura gjatë procesit të rekrutimit.

Ndihma juridike parësore ofrohet edhe nga Organizatat jofitimprurëse të autorizuara, të cilat japin shërbime në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave¹⁶. Sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017, organizatat jofitimprurëse të autorizuara për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së OJF-ve të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen gjithashtu me Vendim të Këshillit të Ministrave¹⁷.


¹⁶ VKM nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;

¹⁷ VKM nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;

Sipas nenit 15/2 të Ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore duhet të përmbushin këto kritere:

1. të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
2. të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike;
3. të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
4. të kenë përvojë në ofrimin e ndihmës juridike;
5. të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
6. anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.

Siç tregojnë edhe të dhënat e mësipërme, OJF-të ofrojnë shërbim për një numër të lartë qytetarësh që përfitojnë ndihmë juridike falas dhe raportojnë pranë DNJF në lidhje me këto raste. Kjo vjen si pasojë e pranisë dhe ekzistencës së tyre për një kohë më të gjatë në terren krahasuar me QSHNJP-të, si dhe eksperiencës së tyre me çështje të tilla. Aktualisht janë 15 OJF të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë që operojnë në territorin e vendit. Pjesa më e madhe e tyre ndodhet në Tiranë dhe numri i rretheve të mbuluara nga këto organizata mbetet shumë i kufizuar. Koncretisht, 10 nga 15 OJF-të e autorizuar ndodhen në Tiranë, ndërsa rrethet Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat dhe Elbasan kanë përkatësisht nga një organizatë të tillë. Figura e mëposhtme paraqet një ilustrim grafik të shpërndarjes së OJF-ve në territorin e vendit:



Financimet e OJF-ve nga fondet e buxhetit të shtetit janë kryer për herë të parë në mars të vitit 2023, ku vetëm dy prej organizatave kanë plotësuar kriteret përkatëse. Edhe pse të gjitha OJF-të e autorizuar ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike, ekziston një dispozitë në VKM-në nr. 110, datë 06.03.2019, e cila përcakton se për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuar nuk duhet të kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet¹⁸. Pavarësisht qëllimit të mirë të kësaj dispozite, duket se ajo mund të penalizojë një pjesë të OJF-ve për të përfituar fonde, duke qenë se këto të fundit mund të jenë financuar edhe nga donatorë të tjerë në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike. Ligji 111/2017 kërkon që OJF-të të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statut ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dhe të kenë eksperiencë në këtë shërbim. Krahas këtij përcaktimi që fokuson OJF-të e fushës, dispozita e VKM-së praktikisht mund ti përjashtojë ato nga e drejta për tu financuar nga buxheti i shtetit. Qëllimi i mirë i VKM-së për të evituar mbivendosjen e fondeve duhet të ruhet, por pa dekurajuar organizatat të cilat kanë eksperiencë të konsiderueshme në këtë fushë për të aplikuar me projekte dhe ide të reja.

Ndihma juridike parësore ofrohet edhe nëpërmjet Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve, platformës Juristi Online dhe numrit të gjelbër pa pagesë të ofruar nga DNJF. Sipas raportimeve të kësaj Drejtorie, Klinikat e ligjit nuk kanë ofruar shërbim gjatë vitit 2022. Nga intervistat e zhvilluara vihet re se ato operojnë ende në një sërë institucionesh publike dhe private të arsimit të lartë dhe pretendojnë se kanë ofruar ndihmë juridike parësore në disa raste. Megjithatë, nuk konstatohen raportime zyrtare të klinikave të ligjit në DNJF. Ato nuk përfitojnë financime për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe nuk kanë staf të dedikuar për këtë shërbim, por përbëhen kryesisht nga studentë dhe pedagogë që duhet ta ushtrojnë këtë veprimtari krahas detyrave të tyre funksionale. Mosfunksionimi i tyre cenon një nga hallkat e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe zbatimin e neneve 13/c dhe 16 të ligjit 111/2017. Gjykojmë se këto struktura mund të jenë shumë të dobishme në këtë drejtim nëse do të operonin në mënyrën e duhur.

Gjetje nga auditimi 1: Nga vizitat e zhvilluara në terren u konstatua numër i vogël të stafit që ofron shërbim në QSHNJP-të, të cilat funksionojnë me 1 ose në rastin më të mirë 2 juristë. Metodologjia e miratuar sugjeron se prania e vetëm 1 juristi për funksionet e pritjes së parë vlerësohet me “Keq”, ndërsa 2 të tillë vlerësohet me “Mirë”. Ky dokument sugjeron se vlerësimin “Shkëlqyeshëm” do ta merrte zyra me të paktën 5 juristë që kryejnë funksionet e pritjes së parë. Problematika bëhet më shqetësuese në zyrat që operojnë me vetëm një jurist, veçanërisht në drejtim të ndarjes/përcaktimit të detyrave, apo në rastet kur punonjësit i duhet të zhvillojë lejen e zakonshme.

Gjetje nga auditimi 2: Në disa zyra (p.sh. Lezhë) nuk respektohet privatësia e qytetarit duke qenë se shërbimi ofrohet në ambiente të pa izoluar nga mjedisi përreth, apo zyrat pritëse ndajnë ambientet me punonjës të institucioneve të tjera (Fier). Gjithashtu, zyra e Tiranës nuk është e pajisur me një rampë, për të mundësuar aksesin e qytetarëve me aftësi të kufizuara. Metodologjia e miratuar vlerëson me “Keq” rastet kur zyrat e brendshme nuk janë të izoluar nga mjedisi përreth. Ndërkohë, vlerësohet me “Shumë keq” zyra, e cila është plotësisht e pa-aksesueshme nga disa kategori personash me aftësi të kufizuara.

Gjetje nga auditimi 2.1: Në disa raste, edhe vetë kriteret e miratuara janë të vështira për tu zbatuar nga monitoruesit dhe lidhin performancën e qendrave me çështje që nuk janë në kompetencën e punonjësve të tyre. Po ashtu, kriteret e lidhura me nivelin e arsimit dhe eksperiencën në punë nuk reflektojnë një vlerësim të drejtë, për aq kohë sa punonjësi ka plotësuar kërkesat e vendosura gjatë procesit të rekrutimit.

Gjetje nga auditimi 3: Pjesa më e madhe e OJF-ve të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë operon në Tiranë dhe numri i rretheve të mbuluara nga këto organizata mbetet shumë i kufizuar. Konkretisht,

¹⁸ Pika 6 e VKM nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;

10 nga 15 OJF-të e autorizuar ndodhen në Tiranë, ndërsa rrethet Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat dhe Elbasan kanë përkatësisht nga një organizatë të tillë.

Gjetje nga auditimi 4: Përcaktimet e VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019 në lidhje me financimin e OJF-ve të autorizuar nga buxheti i shtetit mund të bëhen pengesë për një pjesë të mirë të OJF-ve me eksperiencë për të përfituar nga kjo skemë.

Gjetje nga auditimi 5: Sipas raportimeve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Klinikat e ligjit nuk kanë ofruar shërbim gjatë vitit 2022.

Konkluzion

- Në raport me metodologjinë e miratuar nga Ministri i Drejtësisë, QSHNJP-të vazhdojnë të jenë jashtë standardeve në drejtim të indikatorëve të sipërpërmendur, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimit ndaj qytetarit, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore. Për më tepër, zyrat që funksionojnë vetëm me një jurist nuk sigurojnë as ndarje të detyrave funksionale.

- Mbulimi i kufizuar i disa rretheve të vendit me QSHNJP, apo mungesa e OJF-ve të autorizuar dhe Klinikave të Ligjit ka cenuar aksesin e qytetarëve në skemën e ndihmës juridike falas. Gjithashtu, qëllimi i mirë i VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019 për të evituar mbivendosjen e fondeve për OJF-të duhet të ruhet, por pa dekurajuar organizatat të cilat kanë eksperiencë të konsiderueshme në këtë fushë.

- Mosfunksionimi i Klinikave të Ligjit cenon një nga hallkat e ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Rekomandim 1.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masat e nevojshme për të evituar funksionimin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me vetëm një jurist, pasi të ketë analizuar edhe ngarkesën e secilës prej tyre.

Brenda qershor 2024

Rekomandim 2.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masat që Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të ofrojnë të gjitha facilitetet e nevojshme, në përputhje me standardet e miratuara.

Brenda qershor 2024

Rekomandim 3.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të hartojë një plan veprimi me synim rritjen e numrit të Organizatave Jo-Fitimprurëse të autorizuar që ofrojnë ndihmë juridike parësore, me fokus të veçantë në rrethet të cilat nuk kanë asnjë organizatë të tillë.

Brenda mars 2024

Rekomandim 4.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të interpretojë VKM-në për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse në mënyrë të tillë që të mos penalizohen OJF-të e autorizuar, të cilat kanë eksperiencë në ofrimin e ndihmës juridike.

Në vijimësi

Rekomandim 5.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë një plan masash me synim rivitalizimin e Klinikave të Ligjit, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Brenda mars 2024

5.2.2 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?


Ndihma juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. E drejta për të pasur një mbrojtës ligjor, është një nga të drejtat procedurale thelbësore në një gjykim, pasi vetëm në këtë mënyrë respektohet në mënyrë efektive parimi i kontradiktoritetit dhe palët ndërgjyqëse janë në pozita të barabarta me njëra tjetrën.

Ofrimi i ndihmës juridike dytësore nënkupton ndihmën ligjore të ofruar për përpilimin e akteve apo përfaqësimin ligjor për problematikat zgjidhja e të cilave realizohet nëpërmjet gjykatës. Duke u nisur nga ky fakt, ky shërbim ka një rëndësi esenciale në garantimin e procesit të rregullt ligjor për palët dhe rivendosjen në vend të të drejtave të tyre.

Në ndryshim nga ndihma juridike parësore, shërbimi i ndihmës juridike dytësore jepet në mënyrë ekskluzive vetëm nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë¹⁹.

Pas miratimit të listës së avokatëve nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si institucion përgjegjës për mirë administrimin dhe funksionimin e skemës së ndihmës juridike falas si dhe në zbatim të kompetencave të saj, lidh deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.²⁰

Grafik 5: Avokatët e angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore për vitet 2020-2023



Burimi: DNJF/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat krahasimore për periudhën objekt auditimi konstatojmë se kurba e numrit të avokatëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore ka ardhur në rritje nga viti në vit. Në vitin 2020, numri i avokatëve të angazhuar për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore ishte 68, ndërkohë që për vitin 2023 janë 160 avokatë ofrues të këtij shërbimi. Pas miratimit të hartës së re gjyqësore dhe tkurrjes së numrit të gjykatave, shtrirja gjeografike e avokatëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore mbulon të gjitha gjykatat e rrethit²¹. Ndërkohë që, më herët,


¹⁹ Ligjit nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti", neni 7, pika ë;

²⁰ Ligjit nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti", neni 8, pika k;

²¹ Konkretisht, për vitin 2023 janë angazhuar 57 avokat në Tiranë, 3 në Berat, 1 në Sarandë, 2 në Gjirokastrë, 27 në Durrës, 12 në Elbasan, 13 në Fier, 1 në Kukës, 2 në Pogradec, 1 në Dibër, 9 në Lezhë, 9 në Lushnjë, 8 në Shkodër, 7 në Vlorë dhe 8 në Korçë;

pavarësisht rretheve ku vepronin gjykatat të shkallës së parë, në disa prej tyre nuk ka pasur asnjë avokat të përfshirë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.


Grafik nr.6: Avokatët e angazhuar në ofrimin e ndihmës juridike dytësore për vitin 2023



Burimi: DNJF/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Një nga risitë që solli reforma në drejtësi dhe ligji i ri për ndihmën juridike ishte edhe zgjerim i rrethit të subjekteve përfituese. Sa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se **28%** e përfituesve janë në pamundësi financiare, **61%** janë kategori të veçanta ligjore, ndërsa **11%** e tyre janë kategori e papërcaktuar.

Grafik nr. 7: Kërkuesit e ndihmës juridike dytësore sipas vendime gjyqësore për vitin 2022



Burimi: DNJF

Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike dytësore inicohet në çdo rast në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit nr.111/2017. Mesatarja aritmetike e kërkesave të pranuar për ndihmë dytësore juridike është përafërsisht **85** kërkesa për muaj²².

Kërkesa për ofrimin e ndihmës juridike dytësore bëhet nëpërmjet plotësimit të formularit të aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore”. Përveç të dhënave personale, aplikimi duhet të shoqërohet edhe me dokumentacion provues për kushtet e pamjaftueshmërisë financiare të aplikantit (shih figurën nr. 3). Mirëpo, në asnjë akt nënligjor nuk përcaktohet specifikisht se cilat janë

²² Analiza Vjetore e Performancës 2022 e DNJF-së;

dokumentet që qytetari duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare. Mungesa e një përcaktimi të tillë mund të sjellë refuzim të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore. Duke marrë në konsideratë që risku për mungesë informimi tek grupet që përfitojnë nga skema e ndihmës juridike falas është i lartë dhe se qytetarët mundën ta plotësojnë kërkesën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore edhe vetë, pa qenë nevoja të paraqiten në QSHNJP, dokumentacioni që ata duhet të bashkëlidhin në formularin e aplikimit për të vërtetuar gjendjen e tyre financiare duhet të jetë i mirë përcaktuar.

Figura nr. 3: Formulari i aplikimit për përfitimin e ndihmës juridike dytësore

RUBRIKA 5: DOKUMENTACIONI SHOQERUES

Ky aplikim shoqerohet nga dokumentat si me poshte:

A. Dokumenta Identifikimi te Aplikantit;

.....
.....
.....
.....

B. Dokumenti i autorizimit per perfaqesuesin e Aplikantit;

C. Formulari i Vetedeklarimit per Kategorite e Vecanta (shoqeruar me dokumentat bashkelidhur); dhe/ose Formulari i Vetedeklarimit te te Ardhurave dhe Pasurive (shoqeruar me dokumentat bashkelidhur);

D. Dokumenta te tjera:

.....
.....
.....
.....

Në vitin 2017, për herë të parë, një aktor tjetër i rëndësishëm i përfshirë në skemën e ndihmës juridike falas ishte vendimmarrja e gjykatës për përfitimin ose jo të ndihmës juridike dytësore. Lidhur me këtë fakt, nga vendimmarrja e gjykatave evidentohet një marzh shumë i ulët²³ i refuzimit të kërkesave për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

Megjithatë, DNJF mund të akimojë vendimet e gjykatës lidhur me pranimin e kërkesës për ofrimin e ndihmës dytësore. Neni 22 pika 5 i Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” shprehet se: “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë”.

Sa më sipër, nga veprimtaria institucionale e DNJF-së, grupi i auditimit konstaton një numër gjithnjë e më në rritje të ankimeve të vendimeve të gjykatave për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore. Konkretisht:

- **Për vitin 2020** nga totali i 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) vendime me objekt ndihmën juridike dytësore 3 (tre) prej tyre janë ankimuar nga DNJF-ja.
- **Për vitin 2021** nga totali i 849 (tetëqind e dyzet e nëntë) vendime gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore janë ankimuar 70 (shtatëdhjetë) vendime.
- **Për vitin 2022** nga totali i 1030 (Njëmijë e tridhjetë) vendime gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore janë ankimuar 49 (dyzetë e nëntë) vendime.

Pavarësisht faktit se ushtrimi i të drejtës së ankimit nga DNJF përcaktohet në Ligjin nr. 111/2017, ky mjet duhet të përdoret vetëm në rastet kur pranimi i kërkesës nga ana e gjykatës ka qenë dukshëm abuzim ose haptazi i pabazuar.

²³ 7% të totalit;

Pretendimet e DNJF lidhur me ushtrimin e të drejtës së ankimit kanë qenë kryesisht të lidhura me:


- mungesën e arsytimit të plotë nga ana e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike; dhe
- mungesën e citimit të akteve të shqyrtuara nga gjykata për konstatimin e pamjaftueshmërisë financiare.

Konkretisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për periudhën 2020-2022 në 122 raste, nga të cilat deri më tani rezulton se, vetëm 2 kërkesa ankimore janë pranuar. Për rrjedhojë, mjeti i ankimit të vendimeve gjyqësore lidhur me pranimin e kërkesës për ofrimin e ndihmës juridike dytësore duhet të aplikohet vetëm në rastet e cituara në mënyrë eksplicite në ligj (kur vendimi i marrë nga gjykata ka qenë *dukshëm abuzim ose haptazi i pabazuar*).

Në çdo rast tjetër, për pretendime që nuk lidhen me kërkesat e nenit 22 të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, DNJF, në përputhje me nenet 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile, mund ti drejtohet gjykatës që ka marrë vendim për pranimin e kërkesës dhe të kërkoj plotësim të vendimit, saktësim apo interpretim të tij.

Me ndryshimet e reja të kuadrit ligjor për ndihmën juridike, përveç përfaqësimit me avokat falas, qytetarët në nevojë dhe kategoritë vulnerabël kanë mundësi të përfitojnë edhe nga forma e shtuar të shërbimit ligjor falas, ajo e përjashtimit nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Grafik nr. 8: Raporti i kërkesave për shërbimet e ndihmës juridike dytësore



Burimi: DNJF

Referuar të dhënave, në rreth **25%** të totalit të kërkesave qytetarët kanë nevojë vetëm për mbulim të shpenzimeve gjyqësore. Kjo ndihmë konsiston në përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore dhe nga detyrimi për parapagim të tarifave të vënies në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit për individët që do të konsiderohen përfitues të skemës së ndihmës juridike falas. Megjithatë, pavarësisht faktit se ky ligj përjashton personat e trajtuar me ndihmë juridike dytësore falas nga detyrimi për të parapaguar tarifën përmbartimore,²⁴ nuk shprehet për shpenzimet e tjera përmbartimore.

Në rastin e ekzekutimit të vendimeve me objekt takimin e fëmijëve të mitur nga prindi jo-kujdestar (pas divorcit bashkëshortor), neni 523 i Kodit të Procedurës Civile parashikon si kusht të detyrueshëm prezencën e një eksperti psikolog që asiston në këtë takim.


Në referencë të projektit auditues të performancës që KLSH zhvilloj këtë vit në shërbimin përmbartimor shtetëror, problematikave të evidentuara, si dhe pas konsultimit me aktet ligjore në zbatim, grupi i auditimit konstatoj se mungesa e përfshirjes së pagesës së psikologut në skemën e ndihmës juridike dytësore falas vështirëson ekzekutimin e titujve ekzekutivë, duke u bërë pengesë reale në cenimin e të drejtave të prindit jo-kujdestar dhe shkeljen e afateve procedurale gjatë

²⁴ Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 25/b;

ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, përfshirja e tarifave të ekspertëve në skemën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti është thelbësore për mbarëvajtjen e procesit të ekzekutimit të vendimeve, veçanërisht në rastet e takimeve me fëmijët si çështje me karakter sensitiv.

Përsa i përket raportit të natyrës së çështjeve gjyqësore për të cilat kërkohet ofrimi i ndihmës juridike dytësore, konstatohet se pavarësisht faktit se rreth 90% e totalit të çështjeve janë të karakterit civil, kërkesat për përfaqësim në çështje penale nga viti në vit kanë ardhur në rritje. Më konkretisht, në vitin 2019, nga **32** vendime, **4** ishin për çështje penale. Në vitin 2020, nga **181** vendime, **13** ishin për çështje penale, për vitin 2021 nga **849** vendime, **61** ishin për çështje penale dhe, ndërsa për vitin 2022 nga **1030** vendime, **70** ishin për çështje penale.

Grafik nr. 9: Vendime për përfaqësim në çështje penale



Burimi: DNJF/ Përpunoi: Grupi i auditimit

Megjithatë, pavarësisht këtij trendi rritës, nëse i referohemi kritereve që miratohen për procedurën e përzgjedhjes së avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, konstatohet se këto kritere shërbejnë vetëm për avokatët që do të ndjekin proceset civile dhe administrative.

Në udhëzimin e përbashkët ndërmjet DNJF-së dhe DHKA-së, në të cilin skicohen kushtet mbi të cilat do të bëhet përzgjedhja e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore përcaktohet specifikisht se këto kritere do të shërbejnë për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative.

Mungesa e kritereve për avokatët që do të angazhohen në proceset penale tregon për një mungesë fokusi dhe përbën risk për ofrimin e një shërbimi cilësor kah përfituesve.

Kodi i Procedurës Penale sanksionon dy koncepte të mbrojtjes gjatë zhvillimit të një procesi penal: “mbrojtjen e detyrueshme”²⁵ dhe “mbrojtjen për shkak të pamjaftueshmërisë financiare”.²⁶

Në rastin e mbrojtjes së detyrueshme, ligjvënësi bën një përcaktim eksplicit të grupeve që ligjitimohen të përfitojnë mbrojtjen e detyrueshme nga shteti. Kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Në këtë rast, organi i akuzës vihet në lëvizje me kërkesën e personit të pandehur dhe vetëm pasi vërtetohet se plotësohet kushti i pamjaftueshmërisë financiare.

²⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 49;

²⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 49/a;

Lidhur me procesin e caktimit të mbrojtësit për të pandehurin pa mjete të mjaftueshme financiare, në nenin 21 të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përcaktohet se: “1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike detyësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, **organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.** 2. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, **cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike detyësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike detyësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës**”.

Ndërkohë që, në nenin 22 të këtij ligji, paragrafi i parë përcaktohet se: “1. **Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmën juridike detyësore në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji**”.

Nga përcaktimet e parashtruara në nenin 21 dhe 22 konstatojmë se në fazën e procedimit penal, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike detyësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj, duke ja përcjelle më pas këtë vendim Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Vendore të Avokatisë (e cila cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin ndihmë detyësore dhe ja përcjell vendimin gjykatës). Në bazë dhe për zbatim të parimit të një mbrojtjes efektive, si dhe në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, dispozita 21 dhe 22 duhet të trajtohen të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. KEDNJ dhe Kodi i Procedurës Penale flasin për “ndihmë” juridike dhe jo për “emërim” të një përfaqësuesi ligjor. Çka nënkupton rëndësinë e mundësisë për tu mbrojtur në mënyrë reale dhe efektive. Garantimi i të drejtave procedurale duhet të jetë praktik dhe efektiv dhe jo teorik apo formal.²⁷

Për rrjedhojë, në kushtet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare është paraqitur nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, ligjvënësi duhet ti ofrojë atij mundësinë që edhe gjatë procesit të gjyqimit personi i pandehur të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake.

Ndër ndryshimet pozitive që ka pësuar sistemi i drejtësisë penale, është hartimi i një Kodi Penal të Drejtësisë për të Mitur, i cili për herë të parë parashikon në një kuadër të vetëm ligjor rregullat procedurale dhe të drejtat që duhet të zbatohen në rastet kur kemi një të mitur në konflikt me ligjin. Ndryshe nga i pandehuri i rritur, i cili ka të drejtën të zgjedhë të ketë një mbrojtës ose ka të drejtën të mbrohet vetë, në rastin e të pandehurit të mitur, në çdo fazë të drejtësisë penale, çdo i mitur në konflikt me ligjin duhet të përfaqësohet nga një mbrojtës ligjor dhe në rastet kur është në pamundësi, ndihma i garantohet falas nga shteti.²⁸ Mungesa e mbrojtësit ligjor të të miturit gjatë një faze të procedimit penal, e bën procesin gjyqësor të parregullt. Ky parim parashikohet si në Kodin e Procedurës Penale ashtu edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, përcakton gjithashtu se: “**I mituri në konflikt me ligjin ose viktimë mbrohet nga avokatë të specializuar në drejtësinë për të mitur, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat tjetër**”.

Po kështu, edhe në nenin 24 të Ligjit nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, përcaktohet se: “**Avokatët që ofrojnë ndihmë juridike detyësore duhet të jenë të specializuar në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj**”.

Pavarësisht përcaktimeve ligjore të sipërcituara, aktualisht, Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur. Me qëllim implementimin efektiv të këtij përcaktimi ligjor, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, duket ti kërkojë Dhomës Kombëtare të Avokatisë të përgatisë lista të veçanta për avokatët kryesisht, të cilët

²⁷<https://www.osfa.al/sites/default/files/efektiviteti-i-ndihmes-juridike-ne-procesin-penal-ne-shqiperi-res-publica-mars-2016.pdf>;

²⁸ Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mitur, neni 20 dhe Kodi i Procedurës Penale, neni 49.

janë specializuar në mbrojtjen e të drejtave të të miturve, si dhe të kryeje trajnime periodike të avokatëve, duke miratuar kurikula të posaçme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin.

Duhet theksuar se, ndihma juridike dytësore ofrohet nga avokatët dhe për rrjedhojë cilësia e mbrojtjes është e lidhur ngushtësisht me performancën dhe profesionalizmi e punës së tyre. Megjithatë, si institucion kompetent për mirë administrimin e skemës Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka për qëllim të garantojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale dhe cilësore.

Për realizimin e këtij qëllimi, DNJF kryen procese vlerësimi lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike, në përputhje me Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë. Në bazë të këtij akti nënligjor, avokatët e angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore vlerësohen në drejtim të përshtatshmërisë së ambienteve, procesit të punës dhe aftësive profesionale profesionale. Referuar indikatorëve kryesorë të vlerësimit, me qëllim vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore grupi i auditimit konstatoj se disa prej këtyre indikatorëve janë të pa zbatueshëm (përshtatshmëria e cilësisë së shërbimit; cilësia e dokumenteve të hartuara, vlerësimi i analizës së thelluar të çështjes së përfaqësuar; etj.). Përcaktimi i indikatorëve të vlerësimit që nuk mund të aplikohen cenon vlerësimin efektiv të shërbimit dhe garantimin real të të drejtave që duhet t'ju sigurohen personave përfitues.

Njëkohësisht, pavarësisht pretendimeve dhe ankesave të përfituesve të ndihmës juridike dytësore për performancën e avokatit gjatë procesit gjyqësor, kontrolli i performancës së tyre bëhet vetëm në përfundim të procesit dhe pasi është dhënë vendimi nga ana e gjykatës për çështjen objekt gjykimi. Mungesa e mekanizmave të vlerësimit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor nuk garanton përgjegjshmërinë e avokatëve dhe as mbrojtje efektive për përfituesit. Ky fakt, e kthen procesin e vlerësimit të cilësisë së shërbimit të avokatëve në një proces tërësisht formal, duke riskuar garantimin praktik dhe efektiv të të drejtave procedurale të palëve gjatë zhvillimit të një procesi gjyqësor.

Gjetje nga auditimi 1: Formulari i aplikimit *“Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore”* dhe asnjë akt nënligjor që rregullon ofrimin e ndihmës juridike falas nuk përcakton specifikisht se cilat janë dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

Gjetje nga auditimi 2: Në Udhëzimin e Përbashkët nr. 1, datë 15.02.2023 ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore”* nuk përcaktohen kriteret për avokatët që do të angazhohen në proceset penale. Kriteret e parashikuara në këtë udhëzim aplikohen vetëm për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative.

Gjetje nga auditimi 3: Kontrolli i performancës së avokatëve bëhet vetëm në përfundim të procesit gjyqësor dhe pasi është dhënë vendimi nga ana e gjykatës për çështjen objekt gjykimi, pavarësisht pretendimeve dhe ankesave që mund të paraqesin në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas përfituesit e ndihmës juridike dytësore për cilësinë e shërbimit të avokatit gjatë përfaqësimit ligjor.

Gjetje nga auditimi 3.1: Disa nga indikatorët kryesorë të vlerësimit, me qëllim vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore janë të pa zbatueshëm (përshtatshmëria e cilësisë së shërbimit; cilësia e dokumenteve të hartuara, vlerësimi i analizës së thelluar të çështjes së përfaqësuar; etj.).

Gjetje nga auditimi 4: Ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, përkatësisht neni 25 krijon një vakum ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve për personat në pamjaftueshmëri financiare, të cilët përfitojnë nga ndihma juridike dytësore falas. Tarifa e psikologut apo çdo eksperti tjetër gjatë fazës së ekzekutimit nuk

përfshihet në skemën e ndihmës juridike dytësore falas, duke sjellë kështu vështirësi për përmbauesit gjyqësor shtetëror gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Gjetje nga auditimi 5: Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre, sikurse diktohet nga neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Gjetje nga auditimi 6: Referuar legjislacionit në fuqi, në faza të ndryshme të procedimit penal procesi i caktimit të avokatit mbrojtës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare bëhet nga organe proceduese të ndryshme. Kështu, në fazën e hetimit paraprak, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj.

Gjetje nga auditimi 7: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për periudhën 2020-2022 në 122 raste, nga të cilat rezulton se, vetëm 2 kërkesa ankimore janë pranuar nga Gjykata e Apelit. DNJF e ka vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet ankimit edhe për raste që nuk parashikohen në nenin 22 pika 7 të Ligjit nr. 111/2017 (vetëm kur pretendon se vendimi i marrë nga gjykata ka qenë *dukshëm abuzim ose haptazi i pabazuar*).

Konkluzion:

- Mbrojtja juridike dytësore ka një rëndësi të veçantë në garantimin e të drejtës për akses të barabartë në drejtësi. Për rrjedhojë ofrimi i këtij shërbimi me cilësi dhe profesionalizëm garanton mbrojtjen e të drejtave të personave përfitues.
- Me qëllim, sigurimin e cilësisë është e nevojshme të krijohen mekanizma real për vlerësimin e performancës së ofruesve të shërbimit, si dhe të hartohen indikatorë vlerësimi të aplikueshëm që nxisin përmirësimin e performancës së avokatëve.
- Duke marrë në konsideratë që risku për mungesë informimi tek grupet që përfitojnë nga skema e ndihmës juridike falas është i lartë dhe se qytetarët munden ta plotësojnë kërkesën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore edhe vetë, pa qenë nevoja të paraqiten në QSHNJP, dokumentacioni që ata duhet të bashkëlidhin në formularin e aplikimit për të vërtetuar gjendjen e tyre financiare duhet të jetë i mirë përcaktuar. Kjo pasi, mungesa e një përcaktimi të tillë mund të sjellë refuzim të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe kuadri rregullator kombëtar i krijuar me qëllim ofrimin e ndihmës juridike falas flasin për “ndihmë” juridike dhe jo për “emërim” të një përfaqësuesi ligjor, çka nënkupton rëndësinë e mundësisë për tu mbrojtur në mënyrë reale dhe efektive. Qëllimi primar dhe kryesor skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti është t’i garantoj mbrojtje të barabartë individëve përpara instancave shtetërore (administrative apo gjyqësor).
- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është krijuar me qëllim garantimin e aksesit në gjykatë të personave në nevojë. Mjeti i ankimit nga ana e DNJF-së duhet të ushtrohet vetëm kur ka pretendime se pranimi i kërkesës nga ana e Gjykatës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore është haptazi abuziv ose i paligjshëm. Në këtë rast, DNJF duhet të ketë bindje që personi i cili ka përfituar ndihmën juridike dytësore nuk duhet të përfitojë për shkak se nuk plotëson kushtet e pamjaftueshmërisë financiare ose nuk është pjesë e kategorive të veçanta përfituese që parashikohen në legjislacion. Në çdo rast tjetër, DNJF, për pretendime që nuk lidhen me kërkesat e nenit 22 të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në përpunje me nenet 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile, mund të drejtohet gjykatës që ka marrë vendim për pranimin e kërkesës dhe të kërkojë plotësim të vendimit, saktësim apo interpretim të tij.

Rekomandim nr. 1.1: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të përcaktojnë në Formularin e aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore” edhe dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.
Brenda qershor 2024

Rekomandim nr. 2.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masa për hartimin e kriterëve që duhet të plotësojnë avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset penale.

Në vijimësi

Rekomandim nr. 3.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të analizojë mundësitë për krijimin e një procesi efektiv të vlerësimit të performancës së avokatëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore, që synon nxitjen e performancës së tyre.

Në vijimësi

Rekomandim nr. 4.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masa që në nenin 25 të Ligjit 111/2017 të parashikohet edhe përjashtimi nga shpenzimet e tjera përmbareme për personat e trajtuar me ndihmë juridike dytësore falas.

Menjëherë

Rekomandim nr. 5.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të kërkoj nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë hartimin e listave të veçanta të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandim nr. 6.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas shqyrtoj mundësinë e rishikimit të përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që: “*në rastet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare paraqitet nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, atij ti ofrohet mundësia që edhe gjatë procesit të gjyqimit të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, kur është e mundur*”.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi 7.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të ushtroj të drejtën e ankimit të vendimeve gjyqësore vetëm në rastet e cituara në mënyrë eksplicite në ligj. Në çdo rast tjetër, për pretendime që nuk lidhen me kërkesat e nenit 22 të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, DNJF mund të drejtohet gjykatës që ka marrë vendim për pranimin e kërkesës dhe të kërkoj plotësim të vendimit, saktësim apo interpretim të tij.

Në vijimësi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

7. SHTOJCAT

SHTOJCA I

Qëndrimi i grupit të auditimit lidhur me Komentet dhe Shpjegimet e dërguara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me nr. prot. 1073/3, datë 07.12.2023

Komentet e dërguara nga DNJF janë kryesisht përshkruese dhe nuk kundërshtojnë konstatimet e gjeneruara nga grupi i auditimit, por evidentojnë masat e ndërmarra prej saj ndër vite në kuadër të menaxhimit të sistemit të ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti.

Vetë DNJF, në përmbyllje të komenteve të përcjella (**faqja 23**) ka vlerësuar pozitivisht rekomandimet e gjeneruara nga grupi i auditimit dhe është shprehur konkretisht se: *“Besojmë që rekomandimet dhe sugjerimet tuaja, do na ndihmojnë akoma më shumë në rritjen e performancës së DNJF-së në realizimin e qëllimit të vetë ligjit: Garantimin e ofrimit të ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë në mënyrë profesionale, cilësore, efikente dhe efektive.”*

Gjithashtu, në takimin përmbyllës të zhvilluar ndërmjet DNJF-së dhe grupit të auditimit, subjektit i janë komunikuar të gjitha gjetjet dhe problematikat e konstatuara, në përputhje me Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, për të cilat nuk parashtruar asnjë pretendim.

Në konkludim të këtij qëndrimi janë listuar dokumentet bashkëlidhur observacioneve të dërguara nga DNJF, nga të cilat 53 marrëveshje mirëkuptimi me institucione të ndryshme dhe organe të drejtësisë (disa prej të cilave përsëriten edhe në 2 kopje dhe përbëjnë pjesën më voluminoze të materialit), ndërkohë që bashkëpunimi ndërinstitucional i DNJF-së nuk ka qenë në fokus të këtij projekti auditues. Sa kaq, objektivi i këtij auditimi, i përcaktuar dhe në faqen 14 të Projekt Raportit të Auditimit, ishte:

- Vlerësimi i administrimit të sistemit të ndihmës juridike falas;
- Vlerësimi i strukturave përgjegjëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore; dhe
- Vlerësimi i garantimit të cilësisë së shërbimit të ofruar për kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas.

Më poshtë, gjeni të trajtuara në mënyrë specifike të gjitha komentet e DNJF-së për secilën gjetje dhe rekomandim përkatës, si dhe qëndrimet e grupit të auditimit për to:

Për pyetjen audituese 5.1.1: “A kanë shfrytëzuar MD dhe DNJF kompetencat e tyre në mirë administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas?”

Gjetje nga auditimi 1: Për përcaktimin e pamjaftueshmërisë financiare, ligji merr në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e detyrueshme dhe të nevojshme për jetesë.

Rekomandim 1.1: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike të kryejnë një analizë të mirëfilltë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas.

Qershor 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 1.1, DNJF referon formularin e vetëdeklarimit për të ardhura dhe pasuri, që plotësohet nga aplikantët për të kërkuar ndihmë juridike falas.

Lidhur me këtë fakt, grupi i auditimit thekson se përcaktimi i pamjaftueshmërisë financiare nuk përcaktohet në formularin e plotësuar nga kërkuesit e ndihmës, por në ligjin nr. 111/2017. Metodologjia e përcaktuar në këtë ligj i referohet modelit Slloven, i cili është transpozuar në mënyrë të cunguar, pasi Sllovenia, në ndryshim nga vendi jonë ka një minimumin jetik të përcaktuar, i cili reflektohet edhe në përcaktimin e pagës minimale. Në kushtet kur Shqipëria nuk ka të miratuar një

akt për përcaktimin e minimumit jetik, përlllogaritja e kufirit të pamjaftueshmërisë financiare duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi, por jo shpenzimet e nevojshme dhe të detyrueshme për jetesë është e cenuar dhe rrezikon të përjashtojë nga skema individë, të cilët kanë realisht nevojë për ndihmë juridike falas. Në mënyrë të detajuar kjo çështje është trajtuar që në fazën e shkrimit të Projekt Raportit të Auditimit (faqet 18 dhe 19). Sa kaq, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 2: Disa nga indikatorët e përcaktuar në metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë me qëllim vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike, si për shembull vlerësimi i cilësisë së dokumenteve të hartuara apo analiza e thelluar e çështjes së përfaqësuar nga avokati, janë të pa zbatueshëm.

Rekomandim 2.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë rishikimin e metodologjisë dhe kriterëve të vlerësimit të cilësisë së dhënies së shërbimeve të ndihmës ligjore.

Menjëherë

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 2.1, DNJF shpreh dakordsinë me rekomandimin e gjeneruar nga grupi i auditimit dhe evidenton masat e ndërmarra në funksion të tij. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 4: Drejtoria e Ndihmës Juridike nuk ka një sistem për të matur impaktin e aktiviteteve të zhvilluara me qëllim sensibilizimin e kategorive përfituese të ndihmës juridike falas. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike në këtë kuadër janë zhvilluar në tryeza të rrumbullakëta ose auditorë, ambiente në të cilat shumica e përfituesve të skemës juridike falas nuk kanë akses.

Rekomandim 4.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike, përpara hartimit të kalendarit vjetor të aktiviteteve, të zhvillojë analiza konkrete me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike .

Qershor 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 4.1, DNJF ka pranuar qysh në fazën e terrenit (kthim përgjigje të pyetësorëve drejtuar institucionit) se nuk kryen analiza të tilla. Në shkresën e përcjellë, DNJF shprehet e vetëdijshme për impaktin që ka rritja e ndërgjegjësimit dhe evidenton disa nga veprimet konkrete të ndërmarra dhe vijuese me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Veprimet e ndërmarra nga DNJF janë shqyrtuar në mënyrë analitike nga grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit dhe reflektohen në konkluzionet e gjeneruara **në faqen 20** të Projekt Raportit. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 5: Nga intervista e zhvilluar me Drejtoria e Ndihmës Juridike, u konstatua se përveç koordinorit për të drejtën e informimit, institucioni nuk ka një strukturë apo person përgjegjës që trajton ankesat e qytetarëve.

Rekomandim 5.1: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të përcaktojë një strukturë ose person përgjegjës për trajtimin e pretendimeve të ndryshme që vijnë nga qytetarët, lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar sistemi i ndihmës juridike falas.

Dhjetor 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 5.1, DNJF ka përshkruar procesin e pritjes së qytetarëve dhe jo procedurën e trajtimit të ankesave nga institucioni. Këto janë dy koncepte të ndryshme. Në mënyrë të detajuar çështja lidhur me procedurën e trajtimit të ankesave parashtrohet që në fazën e shkrimit të

Projekt Raportit të Auditimit (faqja 20). Rrjedhimisht, gjetja dhe rekomandimi i gjeneruar nga grupi i auditimit mbeten të pandryshuara.

Gjetje nga auditimi 6: Drejtoria e Ndhmës Juridike nuk ka një program të planifikimit të trajnimeve vazhduese, në bazë të nevojave që lindin nga rastet praktike të trajtuara nga juristët. Krijimi i mundësive për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme, si dhe kualifikimi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira është i ulët.

Rekomandim 6.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me partnerë, të përgatisë një program të brendshëm trajnimesh vazhduese për të siguruar forcimin e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të punonjësve me trajnim të posaçëm.

Në vijimësi

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 6.1, DNJF ka përshkruar trajnimet e zhvilluara për punonjësit e institucionit në bashkëpunim me ASPA, UNDP, etj.. Gjithashtu, DNJF pretendon se zhvillimi i trajnimeve për qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore nuk është kompetencë e saj por e ASPA. Sa kaq, grupi i auditimit thekson se pavarësisht trajnimeve fillestare që organizohen nga ASPA, hartimi i një programi vazhduesh trajnimesh nga vetë DNJF do të mundësonte rritjen dhe forcimin e kapaciteteve dhe për rrjedhojë do të rriste cilësinë e shërbimit të ofruar kah përfituesve të skemës. Njëkohësisht evidentojmë faktin se të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga DNJF në bashkëpunim me ASPA janë marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit që në fazën e terrenit dhe reflektohen në konkluzionet e gjeneruara në faqen 20 dhe 21 të Projekt Raportit të Auditimit. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Për pyetjen audituese 5.2.1: “A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike parësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?”

Gjetje nga auditimi 2: Në disa zyra (p.sh. Lezhë) nuk respektohet privatësia e qytetarit duke qenë se shërbimi ofrohet në ambiente të pa izoluara nga mjedisi përreth, apo zyrat pritëse ndajnë ambientet me punonjës të institucioneve të tjera (Fier). Gjithashtu, zyra e Tiranës nuk është e pajisur me një rampë, për të mundësuar aksesin e qytetarëve me aftësi të kufizuara. Metodologjia e miratuar vlerëson me “Keq” rastet kur zyrat e brendshme nuk janë të izoluara nga mjedisi përreth. Ndërkohë, vlerësohet me “Shumë keq” zyra, e cila është plotësisht e pa-aksesueshme nga disa kategori personash me aftësi të kufizuara.

Rekomandim 2.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masat që Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të ofrojnë të gjitha facilitetet e nevojshme, në përputhje me standardet e miratuara.

Qershor 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 2.1, DNJF ka pranuar problematikën e konstatuar nga grupi i auditimit dhe ka parashtruar disa masa konkrete që do të merren në vazhdim për përmirësimin e kushteve. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 3: Pjesa më e madhe e OJF-ve të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë operon në Tiranë dhe numri i rretheve të mbuluara nga këto organizata mbetet shumë i kufizuar. Konkretisht, 10 nga 15 OJF-të e autorizuara ndodhen në Tiranë, ndërsa rrethet Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat dhe Elbasan kanë përkatësisht nga një organizatë të tillë.

Rekomandim 3.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të hartojë një plan veprimi me synim rritjen e numrit të Organizatave Jo-Fitimprurëse të autorizuara që ofrojnë ndihmë juridike parësore, me fokus të veçantë në rrethet të cilat nuk kanë asnjë organizatë të tillë.

Mars 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 3.1, DNJF ka parashtruar se i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për përcjelljen e listës së OJF-ve që operojnë në vend dhe që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike. Të gjitha OJF-të e listës së paraqitur janë njoftuar në lidhje me hapjen e thirrjes për autorizim.

Sa më sipër, theksojmë se grupi i auditimit është në dijeni të kësaj procedure. Procedura e ndjekur për përzgjedhjen e OJF-ve të autorizuar dhe mënyra e financimit të tyre evidentohet që në fazën e shkrimit të Projekt Raportit të Auditimit (**faqet 26 dhe 27**). Megjithatë, duke marrë në konsideratë mandatin ligjor të DNJF-së, si rregullator në sistemin e ndihmës juridike falas, vlerësojmë se implementimi i këtij rekomandimi, mundëson një rol më proaktiv të DNJF në drejtim të sensibilizimit dhe nxitjes së OJF-ve të fushës për angazhimin e tyre në ofrimin e ndihmës juridike parësore. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 4: Përcaktimet e VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019 në lidhje me financimin e OJF-ve të autorizuar nga buxheti i shtetit mund të bëhen pengesë për një pjesë të mirë të OJF-ve me eksperiencë për të përfutur nga kjo skemë.

Rekomandim 4.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të interpretojë VKM-në për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse në mënyrë të tillë që të mos penalizohen OJF-të e autorizuar, të cilat kanë eksperiencë në ofrimin e ndihmës juridike.

Në vijimësi

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 4.1, DNJF ka cituar dispozitat përkatëse të VKM-së nr. 110/2019 dhe qëllimin e tyre për eliminimin e mbivendosjes dhe keqpërdorimit të fondeve publike. Theksojmë se, grupi i auditimit ka mbajtur në konsideratë të gjitha argumentet e sipërcituara nga DNJF gjatë hartimit të Projekt Raportit të Auditimit dhe formulimit të rekomandimit si dhe ka trajtuar procedurën e ndjekur në mënyrë të detajuar që në fazën e shkrimit të Projekt Raportit të Auditimit (**faqja 28**).

Sa më sipër, rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit është në përputhje me frymën e ligjvënësit në VKM-në nr. 110/2019 dhe kërkon një interpretim të VKM-së që ruan balancën ndërmjet parimit të ekonomicitetit të fondeve publike dhe të drejtës për të përfutur nga këto fonde të OJF-ve me eksperiencë në fushën e ofrimit të shërbimeve juridike. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 5: Sipas raportimeve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Klinikat e ligjit nuk kanë ofruar shërbim gjatë vitit 2022.

Rekomandim 5.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë një plan masash me synim rivitalizimin e Klinikave të Ligjit, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Mars 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 5.1, DNJF ka parashtruar se klinikat e ligjit janë njësi përbërëse të institucioneve të arsimit të lartë dhe se rrjedhimisht nuk janë kompetencë e saj.

Sa më sipër, pavarësisht faktit se klinikat e ligjit janë njësi përbërëse të institucioneve të arsimit të lartë, DNJF është institucioni përgjegjës dhe kompetent të rregullon ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike. Për rrjedhojë, klinikat e ligjit në statusin e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore raportojnë në DNJF në mënyrë periodike. Këto raportime pasqyrohen edhe në analizat vjetore institucionale. Kështu, nëse DNJF konstaton problematika lidhur me ofruesit e shërbimit, në rolin e institucionit rregullator të skemës duhet të propozojë marrjen e masave për mirëfunksionimin e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore pranë MD-së. Kjo çështje është trajtuar në mënyrë të detajuar nga grupi i auditimit që në fazën e shkrimit të Projekt Raportit (**faqja 28**). Për rrjedhojë,

në rekomandimin e gjeneruar folja “të hartoj” u zëvendësua me foljen “të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë”.

Për pyetjen audituese 5.2.2: “A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike detyësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?”

Gjetje nga auditimi 1: Formulari i aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike detyësore” dhe asnjë akt nënligjor që rregullon ofrimin e ndihmës juridike falas nuk përcakton specifikisht se cilat janë dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

Rekomandim nr. 1.1: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të përcaktojnë në Formularin e aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike detyësore” edhe dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

Qershor 2024

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 1.1, DNJF ka përcaktuar dokumente nisur nga praktika, por që nuk parashikohen në formularin që plotësohet nga aplikantët, më konkretisht evidentuar në figurën nr. 3: Formulari i aplikimit për përfitimin e ndihmës juridike detyësore të Raportit të Auditimit, i pasqyruar në faqen 32 të Projekt Raportit të Auditimit. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 3: Kontrolli i performancës së avokatëve bëhet vetëm në përfundim të procesit gjyqësor dhe pasi është dhënë vendimi nga ana e gjykatës për çështjen objekt gjykimi, pavarësisht pretendimeve dhe ankesave që mund të paraqesin në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas përfituesit e ndihmës juridike detyësore për cilësinë e shërbimit të avokatit gjatë përfaqësimit ligjor.

Rekomandim nr. 3.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të analizojë mundësitë për krijimin e një procesi efektiv të vlerësimit të performancës së avokatëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike detyësore, që synon nxitjen e performancës së tyre.

Në vijimësi

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 3.1, DNJF përshkruan procesin e ndjekur për vlerësimin e performancës së avokatëve dhe shpreh dakordësinë lidhur me rekomandimin e gjeneruar nga grupi i auditimit. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 4: Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përkatësisht neni 25 krijon një vakum ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve për personat në pamjaftueshmëri financiare, të cilët përfitojnë nga ndihma juridike detyësore falas. Tarifa e psikologut apo çdo eksperti tjetër gjatë fazës së ekzekutimit nuk përfshihet në skemën e ndihmës juridike detyësore falas, duke sjellë kështu vështirësi për përmbaruesit gjyqësor shtetëror gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Rekomandim nr. 4.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masa që në nenin 25 të Ligjit 111/2017 të parashikohet edhe përjashtimi nga shpenzimet e tjera përmbarimore për personat e trajtuar me ndihmë juridike detyësore falas.

Menjëherë

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 4.1, DNJF përshkruan procedurën dhe referon bazën ligjore të përjashtimit nga tarifat gjyqësore për personat në nevojë, duke sjellë edhe një rast konkret të cilin e kanë evidentuar para grupit të auditimit edhe gjatë fazës së terrenit, por asnjë nga këto dispozita të cituara nuk shprehet lidhur me problematikën e konstatuar nga grupi i auditimit në gjetjen e mësipërme. Çështja e konkluduar nga grupi i auditimit i referohet fazës së ekzekutimit të vendimit,

ndërkohë që rasti i paraqitur nga DNJF referon mbulimin me ekspert gjatë fazës së gjykimit. Kjo çështje trajtohet në mënyrë të detajuar edhe në faqen 33 dhe 34 të Projekt Raportit të Auditimit. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 5: Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre, sikurse diktohet nga neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Rekomandim nr. 5.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të kërkoj nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë hartimin e listave të veçanta të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 5.1, DNJF nuk shpreh asnjë pretendim, por citon në mënyrë përshkruese bazën ligjore dhe detyrimet e Dhomës Kombëtare të Avokatisë në lidhje me përcaktimin e listës së avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për të mitur. E njëjta bazë ligjore është referuar edhe nga grupi i auditimit në trajtimin e pyetjes përkatëse që në fazën e shkrimit të Projekt Raportit të Auditimit (faqet 35 dhe 36). Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 6: Referuar legjisllacionit në fuqi, në faza të ndryshme të procedimit penal procesi i caktimit të avokatit mbrojtës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare bëhet nga organe proceduese të ndryshme. Kështu, në fazën e hetimit paraprak, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj.

Rekomandim nr. 6.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shqyrtoj mundësinë e rishikimit të përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që: “në rastet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare paraqitet nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, atij ti ofrohet mundësia që edhe gjatë procesit të gjykimit të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, kur është e mundur”.

Në vijimësi

Observacion i DNJF: Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 6.1, DNJF citon në mënyrë përshkruese bazën ligjore dhe shprehet se në asnjë fazë të gjykimit nuk është në diskrecionin e saj caktimi i avokatit. Sipas DNJF-së, Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të sigurojnë mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike falas.

Lidhur me këtë fakt, grupi i auditimit sqaron se baza ligjore e cituar nga DNJF është e njëjtë me atë të referuar në pjesën përshkruese të Projekt Raportit (faqet 34 dhe 35). Në asnjë moment grupi i auditimit nuk është shprehur se caktimi i avokatit mbrojtës bëhet nga DNJF. Kjo konstatohet lehtësisht edhe në formulimin e gjetjes, në të cilën evidentohen qartësisht se cilat janë instancat përgjegjëse për caktimin e avokatit në faza të ndryshme të procesit penal. Grupi i auditimit në rekomandimin e gjeneruar i kërkon DNJF-së që të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të përcaktimeve ligjore, në cilësinë e institucionit teknik përgjegjës për rregullimin e skemës së ndihmës juridike falas, me qëllim përmirësimin e këtij procesi dhe ofrimin e një ndihme efektive. Iniciativën për të bërë propozime për përmirësimin e akteve ligjore ose nënligjore, DNJF e dëshmon edhe vet nëpërmjet shkresave bashkëlidhur observacioneve me lëndë: “Propozime drejtuar MD-së për disa ndryshime dhe shtesa

në projekt-aktet që do të nxirren në zbatim të ligjit nr. 111/2017”. Për rrjedhojë, rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Gjetje nga auditimi 7: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për periudhën 2020-2022 në 122 raste, nga të cilat rezulton se, vetëm 2 kërkesa ankimore janë pranuar nga Gjykata e Apelit. DNJF e ka vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet ankimit edhe për raste që nuk parashikohen në nenin 22 pika 7 të Ligjit nr. 111/2017 (vetëm kur pretendon se vendimi i marrë nga gjykata ka qenë *dukshëm abuzim ose haptazi i pabazuar*).

Rekomandim nr. 7.1: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të ushtroj të drejtën e ankimit të vendimeve gjyqësore vetëm në rastet e cituara në mënyrë eksplicite në ligj. Në çdo rast tjetër, për pretendime që nuk lidhen me kërkesat e nenit 22 të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, DNJF mund ti drejtohet gjykatës që ka marrë vendim për pranimin e kërkesës dhe të kërkoj plotësim të vendimit, saktësim apo interpretim të tij.

Në vijimësi

Observacion i DNJF: *Në shkresën nr. 1073/3 prot., datë 07.12.2023, në lidhje me gjetjen e mësipërme dhe rekomandimin përkatës nr. 6.1, DNJF nuk parashtron asnjë pretendim lidhur me rekomandimin, por thjesht citon bazën ligjore. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, grupi i auditimit gjykon të arsyeshme që të plotësojë rekomandimin me disa elementë të cilët janë trajtuar edhe në narrativë gjatë fazës së shkrimit të Projekt Raportit të Auditimit (faqet 32 dhe 33). Për rrjedhojë, në rekomandim u shtua fjalia e dytë.*

Aktet e përcjella nga DNJF në mënyrë rendore:

- Një (1) kopje të Projekt-Raportit të Auditimit;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Bashkisë Përmet e vitit 2023 **(2 kopje)**;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për vitet 2020 dhe 2023;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitet 2020 **(2 kopje)** dhe 2023;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për vitet 2020 dhe 2023;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitet 2020 dhe 2023;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e vitit 2023 **(2 kopje)**;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë për vitet 2020, 2022 dhe 2023 **(2 kopje)**;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Qendrës “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë” e vitit 2023;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për vitet 2020 dhe 2023;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e vitit 2022;
- Shkresë nr. 1195 prot., datë 23.03.2022 “Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të ofrimit të vendosjes në dispozicion të një posti pune pa kundërshtim pranë Gjykatës së Rrethit Elbasan”;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vitet 2020 dhe 2022;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DNJF-së dhe Bashkisë Kukës e vitit 2022;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet MD-së dhe Bashkisë Vlorë e vitit 2021;

- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet MD-së dhe Bashkisë Pogradec e vitit 2021;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DNJF-së dhe Bashkisë Berat e vitit 2021;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet MD-së dhe Bashkisë Lushnje e vitit 2020;
- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DNJF-së dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Shoqatës së Invalidëve të Punës e vitit 2021;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës Administrative Shkodër e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Apelit Korçë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës Administrative Durrës e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Apelit Vlorë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Apelit Tiranë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Apelit Shkodër e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Apelit Durrës e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës Administrative Korçë e vitit 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për vitin 2020;
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Gjykatës Administrative Vlorë e vitit 2020;
- Kalendar i Aktiviteteve për vitin 2023 për secilin rreth ku janë të vendosura Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP);
- Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DNJF-së dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve;
- Lista e Ndihmës Juridike për vitin 2023;
- Praktikë përmbaremore e bashkëpunimit ndërmjet DNJF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit;
- Propozime drejtuar MD-së për disa ndryshime dhe shtesa në projekt-aktet që do të nxirren në zbatim të Ligjit nr. 111/2017;
- Pjesë nga Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2023;
- Raporti i Bankës Botërore “Për Barazinë Gjimore”, 2022.

Në përfundim, theksojmë se pavarësisht fokusit të këtij projekti auditues të gjitha dokumentet e bashkëlidhura observacioneve janë konsultuar nga grupi i auditimit edhe gjatë fazës së terrenit dhe komentet e parashtruara nga DNJF marrin përgjigje në narrativen e shkruar nga grupi i auditimit që në fazën e shkrimit të Projekt Raportit.

Me respekt, Grupi i Auditimit

SHTOJCA II



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 09/10/2023

Lënda: Kërkesë për informacion lidhur me auditimin e performances me temë
“Ndhima juridike falas për personat në nevojë”

Drejtuar: Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 3, pika 1 dhe 4, si dhe neni 13 i këtij ligji, është duke kryer auditimin e performancës “*Ndhima Juridike Falas për Personat në Nevojë*”, për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 - 30.06.2023.

Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 3000 - 3200), bazuar në Nenin 26 të Ligjit Nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, kërkohet përgjigje dhe vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare shkresore (dhe elektronike ku është e mundur), si më poshtë:

1. A mbahet një regjistër nga ana e DNJF për ankesat e qytetarëve në lidhje me ndihmën juridike të ofruar nga QSHNJP, OJF-të e autorizuara dhe avokatët?
2. A ka një metodologji të përcaktuar për menyrën e trejtimit të ankesave dhe pretendimeve të ndritura pranë DNJF-së nga përfituesit e skemës?
3. A mbahen parasysh dhe trajtohen ankesat specifike të qytetarëve gjatë ushtrimit të monitorimeve dhe kontrolleve në QSHNJP?
4. A bën DNJF analiza për të matur impaktin e aktiviteteve ndërgjegjësuese të zhvilluara?
5. A ka DNJF një planifikim për rritjen e efektivitetit të klinikave të ligjit pranë IAL-ve?

6. A ka bashkëpunuar Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore me Klinikat Ligjore për trajnimin dhe përditësimin e studentëve të përfshirë mbi çështjet e lidhura me NJP?
7. A ka bashkëpunuar DNJF me DAP për miratimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm? A rishqyrtohen në mënyrë periodike standardet e programeve të trajnimit për punonjësit me trajnim të posaçëm?
8. Lutemi vini në dispozicion procedurën e financimit për OJF-të e licencuara për vitin 2023 (përfshirë vlerësimin e plotësimit të kritereve), si dhe një listë me rrethet ku operon secila OJF e licencuar.
9. Sa vendime gjyqësore për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore janë ankimuar gjatë periudhës objekt auditimi? Lutemi vini në dispozicion parashtrimet tuaja për secilin rast.
10. Lutemi vini në dispozicion një listë me numrin e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në secilin rreth, si dhe numrin e çështjeve të trajtuara nga secili avokat.

Përgjigjet duhet të jepen për çdo pyetje, me argumente dhe komente sqaruese. Gjithashtu, lutemi të na vini në dispozicion gjithë dokumentacionin, evidencat, raportet, bazën ligjore apo praktikat e mira në rast se kërkohet apo kur gjykoni se ka nevojë për dokumente mbështetëse.

Ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin!